

Analiza Vjetore e Punes 2016



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

Departamenti i Informacionit Shëndetësor, Teknologjisë dhe Komunikimit

Departamenti i Informacionit Shëndetësor, Teknologjisë dhe Komunikimit (DISTK) paraqet si më poshtë një përmbledhje të aktiviteteve dhe arritjeve të këtij Departamenti për vitin 2015:

1. Ri-freskimi i indeksimit të Revistës Mjekësore sipas kriterit të Index Copernicus.

Bazuar në aktivitetin dhe cilësisë në rritje të Revistës Mjekësore u bë i mundur rifreskimi i klasifikimit të Revistës Mjekësore sipas kriterit të Index Copernicus, duke kaluar nga 47.73 në 2015 në 49.05 për vitin 2016, duke shënuar kështu progres të rëndësishëm.

Gjithashtu, u aplikua për indeksimin e Revistës Mjekësore në indekse të tjera të tillë si Embase, Scopus, PubMed, etj, për të cilat jemi në pritje.

2. Botimi i 4 numrave të Revistës Mjekësore.

Gjatë vitit 2016 ka vazhduar puna e zakonshme me redaktimin, përkthimin dhe gjithë proceset e tjera në kuadër të mbarëvajtjes së Revistës Mjekësore. Gjatë vitit 2016, u botuan 4 numra me mbi 50 artikuj shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Revista është botuar në Shqip dhe Anglisht.

3. Botimi i 4 numrave tëBuletinit të ISHP-së.

Gjatë vitit 2016 stafi i DSTK-së bëri përpjekje maksimale për sigurimin e materialeve për Buletinin e ISHP-së, i vetmi organi periodik i cili informon lidhur me aktivitetet e ISHP-së dhe të shëndetit publik në Shqipëri. Gjatë vitit 2016 u botuan 4 numra të Buletinit, duke përfshirë mbi 20 materiale të larmishme përfshirë shpërthime epidemike dhe trendet në kohë të sëmundjeve të ndryshme, ecurinë e vaksinimit, lidhjen e nivelit të varferise me nivelin e vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë, etj. Stafi i DSTK-së ka bërë një punë të lavdërueshme për përkthimin dhe redaktimin e artikujve. Buletini ka dalë në Shqip dhe Anglisht.

4. Kryerja e 95% të punës lidhur me kornizën e indikatorëve ECHI.

Gjatë vitit 2016, DISTK shtyu përpara procesin e kompletimit të kornizës së indikatorëve ECHI, të hartuar dhe miratuar gjatë vitit 2014-2015. Indikatorëve ECHI synojnë të standardizojnë mënyrën e raportimit të informacionit shëndetësor në Shqipëri.

Gjatë vitit 2016 u finalizua manuali i indikatorëve ECHI si dhe pothuajse ka përfunduar guida e indikatorëve ECHI, dy arritje keto mjaft të rëndësishme për DISTK dhe për ISHP në përgjithësi. Manuali i indikatorëve ECHI është tashmë i disponueshëm për t'u përdorur nga palët e interesuara si dhe shërben si një busull/guide drejtuese për të gjitha aktivitetet e ISHP dhe mënyrën si mbledhet dhe raportohet informacioni lidhur me shëndetin e popullatës. Ndërsa guida e indikatorëve ECHI gjithashtu ka përfunduar dhe jemi në hapat e fundit të faqesjes dhe botimit të saj. Ky dokument do të jetë gati në fillim të vitit 2017.

5. Vazhdimi me intensitet i punës për shtrirjen në të gjithë vendin të sistemit të survejancës së praktikave të ushqyerjes së fëmijëve 0-2 vjeç dhe indikatorëve të rritjes për fëmijët 0-5 vjeç

Gjatë vitit 2016 u realizua një volum i madh pune për shtrirjen në shkallë kombëtare të sistemit të survejancës së praktikave të ushqyerjes së fëmijëve 0-2 vjeç dhe indikatorëve të rritjes për fëmijët 0-5 vjeç. Në këtë mënyrë, u realizuan vizita pune dhe trajnuese në të gjitha rrethet e vendit për të shpjeguar sistemin, indikatorët që duhet të maten dhe si duhet të maten dhe mënyrën e re të raportimit të tyre. Gjithashtu, paralelisht me këto aktivitete trajnuese dhe sensibilizuese të cilat arritën në total rreth 1500 punonjës të kujdesit të nënës dhe fëmijës (infermiere, mjeke të ambulancave dhe qendrave shëndetësore të fshatrave dhe qytetit, operatorë të njësive të statistikës në nivel DSHP-je), u bënë përpjekje për rindertimin e software-it për raportimin e këtyre indikatorëve, duke synuar krijimin e një programi online që do të mundësonte hedhjen në kohë reale të të dhënave të raportuara dhe analizimin po në kohë reale të indikatorëve në nivel qendror shëndetësor, rrethi dhe nivel kombëtar. Për këtë qëllim u realizuan disa takime me donatore të ndryshëm për të mundësuar financimin e këtij programi dhe aktualisht jemi në fazën përfundimtare të mbylljes me sukses të këtij procesi.

6. Hartimi dhe botimi i raportit kombëtar të studimit ESPAD 2015

Në vitin 2016 u bë i mundur analizimi i të dhënave të projektit ESPAD 2015 dhe hartimi i raportit përkatës në nivel kombëtar. Ky studim u krye për herë të dytë në Shqipëri në vitin 2015 duke mundësuar gjenerimin e të dhënave për përdorimin e alkoolit dhe substancave të tjera psikoaktive tek nxënësit e shkollave në Shqipëri dhe vlerësimin e trendeve të përdorimit të substancave psikoaktive midis periudhës 2011-2015.

Raporti i lancua ne 27 Tetor 2016 ne ambjentet e hotel Tiranes duke patur mbulim te gjere mediatik. Mund te themi qe studimi ESPAD 2015 dhe raporti i tij ne vitin 2016 jane nder suksese me te prekshme te DISTK-se gjate vitit 2016.

7. Ngritja e Sistemit te Paralajmerimit te Hershem (EWS) per Substancat e Reja Psikoaktive (SRP) ne Shqiperi

Ne datat 1-2 Dhjetor 2016 u organizua, nen udheheqjen e ISHP, takimi i pare per ngritjen e Sistemit te Paralajmerimit te Hershem per Substancat e Reja Psikoaktive ne Shqiperi, ne ambjentet e Ministrise se Shendetesise dhe me pjesemarrjen e perfaqesuesve te larte te ISHP, MSh, Ministrise se Brendshme, NGO-ve te ndryshme, QSUT-ve, Institutit te Mjekesise Ligjore, etj. Ky aktivitet u mbeshitet dhe nxit nga EMCDA ne kuader te projekteve IPA5.

Ky takim hodhi bazat per ngritjen e sistemit EWS per SRP-te ne vendin tone. Takimi ishte nje sukses dhe do te pasohet nga te tjera takime ne vitin 2017.

8. Pergatitjes per realizimin e Pyetesorit European per Anketimin e Organizatave (PEAO ose EFSQ) ne Shqiperi

Ne datat 13-14 Dhjetor 2016 ne Lisbonë hartuam planin paraprak kombetar per realizimin e Pyetesorit European per Anketimin e Organizatave (PEAO ose EFSQ) ne Shqiperi, i cili synon te marre informacione te detajuara nga cdo institucion qe ofron sherbime per personat e varur nga substancat psikoaktive dhe cdo lloj varesie tjeter (alkooli, bixhozi, etj) ne Shqiperi me qellimin final hartzimin e rrjetit te institucioneve te tilla dhe sherbimeve qe ofrohen ne nivel vendi ne menyre qe kjo te sherbeje si baze vleresimin e nevojave dhe ndermarrjen e masave perkatese per ofrimin e sherbimeve te duhura per keto grupe te popullates. Plani kombetare per kete ushtrim do te miratohet dhe zbatohet ne vitin 2017.

9. Pjesëmarrja në aktivitete shkencore të ndryshme

Punonjësit e DISTK kanë marrë pjesë në një sërë konferencash shkencore gjatë vitit 2016, takime, workshope dhe aktivitete promovuese.

10. Mirëmbajtja dhe pasurimi i faqes web të ISHP.

DISTK ka përgjegjësinë për mirëmbajtjen, funksionimin dhe pasurimin e faqes web të ISHP-së. Stafi i DISTK-së ka luajtur rol aktiv për sigurimin e dokumentave përkatës, rifreskimin e informacioneve në faqe si dhe është marrë me detajet teknike të mbarëvajtjes së kësaj faqeje.

11. Mirëmbajtja e rrjetit të informacionit dhe teknologjisë së ISHP-së.

DISTK ka në stafin e tij personat përgjegjës për mirëmbajtjen e rrjetit të informacionit dhe teknologjisë në ISHP. Kjo detyrë është realizuar me sukses duke ju përgjigjur në kohë cdo problemi të shfaqur për të garantuar vijueshmërinë e punës.

12. Përgjigja ndaj kërkesave të departamenteve të ISHP-së lidhur me hedhjen e të dhënave

Gjatë vitit 2016 DISTK ka dhënë kontributin e tij për të hedhur një volum të madh të dhënash nga forma “në letër” në formë “elektronike” nga të gjithë departamentet e ISHP-së, duke mundësuar në këtë mënyrë përdorimin e këtyre të dhënave, analizimin e tyre dhe interpretimin e tyre nga specialistët përkatës.

13. Redaktimi i materialeve të ndryshme në kuadër të aktivitetit të përgjithshëm në ISHP

Gjatë vitit 2016 DISTK ka dhënë kontributin e tij për të redaktuar nga ana letrare një numër të madh materialesh të ardhur nga të gjithë departamentet e ISHP-së. Ky proces i rëndësishëm siguron minimizimin e gabimeve ortografike në këto materiale dhe mbijetjen e standardit të gjuhës letrare dhe shkencore të materialeve të prodhuara nga ISHP.

Shendeti dhe Mjedisi

Nr.	Aktivitetet	Periudha
1	Në bashkëpunim me Sektorin e epidemiologjisë ambientale dhe cilësisë së ajrit, si edhe laboratorët e dept., është hartuar dhe realizuar faza e parë dhe e dytë e aktiviteteve të programit të punës: “Vlerësimi i ndikimit në shëndet të faktorëve mjedisore në popullatat pranë vendgrumbullimit të mbetjeve urbane”.	Janar – dhjetor 2016
2	Mbledhja dhe përkthimi i materialeve për përgatitjen e një artikulli për botim në Buletin e ISHP-së me temë: “Kontenierët e mbetjeve urbane dhe shëndeti publik”	Janar – Gusht 2016
3	Pjesëmarrje në takime pune, seminare ose konferenca në fushën e shëndetit publik	Maj – Nëntor 2016
4	Konsultime me studente të inxhinierisë së mjedisit, Fakulteti i Inxhinierisë së Mjedisit	Mars – Nëntor 2016
5	Konsultime me specialistë në fushën e shëndetit publik për mbetjet	
6	Ndjekja e procedurave si: kthim përgjigje të shkresave të ardhura nga institucione shtetërore ose subjekte private, pritje mostrash uji dhe hartime të	Janar – dhjetor 2016

	raport analizave.	
7	Pritje mostrash të ujërave (Ujëra pusesh dhe rrjeti, ujëra shkarkimesh, ujra sipëfaqësore, lëndë dezinfektante, nga subjekte si dhe nga DSHP/DRSH) për analizë, regjistrimi dhe dërgimi në laboratorë. Hartimi i raport analizave përkarëse.	Janar – dhjetor 2016
8	Përpilim Kthim Përgjigje për subjektet.	Janar – dhjetor 2016
9	Pjesëmarrje në grupe pune ndërinstytucionale, për Përgatitjen e Strategjisë Kombëtare të menaxhimit të Burimeve Ujore, si dhe Përgatitjen e Kadastrës Ujore, në zbatim të Ligjit Për menaxhimin e Integruar të Burimeve ujore.	
10	Monitorimi mikrobiologjik i Ujërave Bregdetare të larjes (periudha Maj – Tetor).	Maj-Tetor 2016
11	Trajnim i personelit të Shërbimit të Shëndetit Mjedisor të DSHP/DRSH të rretheve, me kërkesë të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë (gjithë vitin).	Janar-Dhjetor 2016
12	Praktikë mësimore për studentet e Mjekësisë.	Janar-Dhjetor 2016
13	Botim i dy artikujve në Revista Shkencore.	Janar-Dhjetor 2016
14	Pjesëmarrje në Konferenca. (Brenda dhe jashtë vendit).	Janar-Dhjetor 2016
15	Pjesëmarrje në grupet ndërinstytucionale me tematike Uje per njerez ,Uje per mjedis	Shtator –Dhjetor 2016
16	Pjesëmarrje në grupin ndërinstytucional të grupit të punës për plotësimin e anketeve të GLASS i përgatitur nga OBSH	Nëntor –Dhjetor 2016
17	Përgatitja e ndryshimeve të VKM për Ujin e pijshëm Nr 379 dt 25.05.2016 dhe venia në zbatim të saj .	Shtator –Nëntor 2016

Departamentit të Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit

Departamentit i Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor ka si mision përmirësimin e shëndetit të njerëzve nëpërmjet rritjes së kontrollit mbi shëndetin.

Nëpërmjet Edukimit Shëndetësor njerëzve u jepet mundësia që të mësojnë rreth shëndetit të tyre dhe të ndryshojnë sjelljen e tyre. Këtu përfshihet:

- **Rritja e ndërgjegjësimit** të njerëzve për çështjet që lidhen me shëndetin dhe faktorët që kontribuojnë në shëndet.
- **Ofrimi i informacionit shëndetësor**
- **Motivimi dhe bindja e njerëzve për të ndryshuar stilin e tyre të jetës** për të përmirësuar shëndetin e tyre.
- **Pajisja e njerëzve me aftësi** dhe besim për t'i bërë këto ndryshime.

Departamenti i Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor nuk përqendrohet, në punën e tij, vetëm tek individ, por merr në konsideratë edhe faktorët e tjerë social, ekonomik dhe politik, që përcaktojnë shëndetin. Kjo, pasi shëndeti është përgjegjësi e përbashkët e gjithë shoqërisë. Mjedisi e veprimtaria politike është gjithashtu në fokus të këtij departamenti.

Promovimi i shëndetit kryhet nëpërmjet:

Advokacisë - Ky departament kryen advokaci duke paraqitur interesat e grupeve të disavantazuara të popullatës, duke folur në interes të tyre ose duke lobuar për të influencuar politikat e ndryshme qeveritare në mbrojtje të shëndetit të këtyre grupeve.

Mundësimi - Departamenti ka për qëllim të reduktojë diferencat në statusin e shëndetit dhe të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë njerëzit që të arrijnë plotësisht potencialin e tyre për shëndet.

Ndërmjetësimi - Detyrë e departamentit është edhe, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet agjencive dhe sektorëve të ndryshëm qeveritarë dhe joqeveritarë për të përmirësuar shëndetin e popullatës.

Gjatë vitit 2016, departamenti i Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit ka zhvilluar një sërë aktivitete me karakter edukativ, informativ, kërkimor-shkencor me qëllimin final përmirësimin e shëndetit të popullatës nëpërmjet promovimit të një stili jetese të shëndetshme. Aktiviteti i punës së departamentit gjatë këtij viti ka qenë orientuar në këto drejtime kryesore:

1. Ndërtim, rritje dhe forcim kapacitetesh kombëtare në fushën e shëndetit, me audienca dhe çështje shëndetësore të ndryshme:

- Takim me punonjësit e Kabineteve të Promocionit të rrethave për temat:
- Organizimi i aktiviteteve edukuese promociionale në disa shkollat në Durrës dhe Elbasan

- Aktivitete sensibilizuese per ushqyerjen e shendetshme te te rinjte e shkollave te mesme ne Burrel, Bulqize
- Aktivitet sensibilizues per « Nje ushqyerje te shendetshme te femije », shkolla 9 vjecare Niket Dardani ne Tirane.
- Aktivitet sensibilizues me mjeket e shkollave te Tiranës ne ambientet e ASHR per Diten Boterore te veshkave.
- Aktivitet sensibilizues per Diten Boterore te Veshkave. Ky aktivitet u organizua ne bashkepunim me ISHP, ASHR, Shoqatën e Nefrologeve, dhe Roshe.
- Aktivitete ne dy shkolla 9 vjecare lidhur me Diten Boterore te veshkave ku ishin te ftuar nxenes dhe prinder. (Osman Myderizi) Niket Dardani
- Aktivitet sensibilizues ne ditën boterore te diabetit ne bashkepunim me aktore te tjere ne sheshin “Nene Tereza”.
- Aktivitet sensibilizues për shëndetin mendor (shkolla “Niket Dardani”, “Isa Boletini”.
- Aktivitet sensibilizues për parandalimin e dhunës në shkolla (Paskuqan)
- Aktivitet në kuadër të muajit të Ndërgjegjësimit për Autizmin me stafet psikosociale ne DSHP-të e rretheve.
- Aktivitet sensibilizues në kuadër të Dita Ndërkombetare Kunder Abuzimit dhe Trafikimit me Droga.
- Aktivitet sensibilizues në kuadër të 12 Maj , Dita Ndërkombëtare e Infermierit
- Aktivitet sensibilizues në kuadër të 10 Shtatorit, Dita Botërore për Parandalimin e Vetëvrasjes
- Aktivitet sensibilizues në kuadër të 10 tetor 2016, Dita Botërore e Shëndetit Mendor
- Aktivitet sensibilizues në kuadër të 3 Dhjetorit, Dita Botërore e Personave me Aftësi të Kufizuara.
- Aktivitet sensibilizues në kuadër të 19 Nëntorit, Ditës Botërore të Parandalimit të Abuzimit me Fëmijët
- Aktivitet sensibilizues në kuadër të dy ditëve botërore; 19 Nëntori, Dita Botërore e Parandalimit të Abuzimit me Fëmijët dhe 20 Nëntori, Dita Universale e Fëmijëve
- Trajnim “*Trajtimi i simptomave të depresionit, ankthit, stresit*”, i akredituar nga QKEV(qershor 2016) .
- Trajnim “ *Gjurmimi dhe trajtimi i Varësisë nga droga*”, i akredituar nga QKEV (dhjetor 2016).
- Trajnim “*Dhuna, format dhe parandalimi i saj*” i organizuar në Albanian University (maj 2016) dhe kopshtin Nr 40 “Nene Tereza” (qershor 2016).

- Trajnim dy ditor me stafe të Sektorit të Edukimit nga Insitucionet e Vuajtjes së Dënimit (tetor 2016).
- Trajnim kombetar i stafit te promocionit ne rrethe me teme për “Aktivitetin fizik dhe Parandalimin e Semundie kardiovaskulare” (shtator 2016).
- Trajnim i personelit shendetesor paresor “Survejanca e praktikave te ushqyerjes dhe te rritjes te femijet e moshes 0 – 5 vjeç (shtator-dhjetor 2016).
- Trajnim i Trajnereve (ToT) me temë“ Shëndeti dhe mirëqënia e fëmijëve, trajnimi i Home visitors për të mbështetur familjet në zhvillimin, mbrojtjen dhe shëndetin e fëmijëve” .
- Trajnim i Trajnereve (ToT) te mjekeve te paresorit ne Kosove per paketen e “Vizitoreve ne shtepi” mbeshtetur nga UNICEF.
- Fokus grupet ne Durres per vleresimin e praktikave te shendetshme te ushqyerjes se femijeve (mars 2016).
- Përfundimi i hartimit të një programi dy ditor trajnimi për Shëndetin Riprodhues, përgatitja e gjithë setit të materialeve dhe prezantimeve për trajnimin dhe akreditimi i tij nga QKEV
- Organizimi i dy trajnimeve mbi ShRiprodhues me stafin e shërbimit shëndetësor parësor në Memaliaj/Tepelenë
- Organizimi i trajnimit mbi Shëndetin Riprodhues (të akredituar) me mjekët obstetër gjinekolog dhe pediatër të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor të disa poliklinikave në Tiranë
- Organizimi i dy trajnimeve mbi ShRiprodhues me stafin e shërbimit shëndetësor në rrethin e Delvinës
- Vizita monitoruese në rrethet MMadhe dhe Vlorë në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit kundër Kancerit të Gjirit
- Organizimi i takimeve ndërgjegjesuse në 12 Qarqet, në DRSH, mbi Emergjencat e lidhura me ujin e pijshem.
- Monitorimi i qendrave Shëndetësore në Tiranë dhe Durrës mbi implementimin e indikatorëve të ushqyerjes dhe rritjes së fëmijëve 0-5 vjeç

2. Pjesëmarrje ne grupe pune për dokumente te ndryshme strategjike

- Pjesëmarrje në grupin e punës të Specifikimeve të shtypshkrimeve të ISHP për vitin 2016.
- Pjesëmarrje ne grupin e punës për hartimin e “Strategjinë e Sistemit Shëndetësor 2016 - 2020”.
- Pjesemarrje ne grup pune per hartimin e Planit te Veprimit te Promocionit te Shendetit 2017-2021.
- Pjesemarrje ne grup pune per hartimin e Strategjisë së Shëndetit Riprodhues 2017-2021.

3. Hartim materialesh informative

Hartim Broshurash me temë

- ✓ Menopauza
- ✓ Nderhyrje te shkurtra per alkoolpirjen e demshme dhe te rrezikshme
- ✓ Depresioni dhe Crrregulimet Bipolare
- ✓ Te edukojme femijet duke i mbrojtur ato
- ✓ Femijet me nevoja te veçanta
- ✓ Per prinderit me femije autike

- Hartim fletëpalosje, me temë:

- ✓ “ Ndikimi i Alkoolit dhe Drogave ne shendetin tone mendor”
- ✓ “ Anomalitë e lindura”
- ✓ “ Pastertia eshte shendet”
- ✓ “Jini aktive gjithe jeten”
- ✓ “Fletepalosje per kancerin e gjirit”
- ✓ “Si te mbrojme femijet nga dhuna”
- ✓ “Demenca:
- ✓ “Femijet me nevoja te veçanta”

- Hartim posterash, me temë:

- ✓ Parandalimi i dhunes ndaj femijeve
- ✓ Ushqyerja e shendetshme tek adoleshentet
- ✓ Parandalimi i defekteve te lindura
- ✓ Poster per kancerin e qafes se mitres

4. Shkrime raportesh

- Raporti “*Pilotimi i disa indikatorëve kyç shëndetësorë në Shqipëri*”
- Raport i studimit mbi “*Vlerësimin e njohurive, qendrimeve dhe praktikave ne perdorimin e antibiotikeve ne popullaten e pergjithshme (Tirane, Vlore, Shkoder)*”.
- Raport “*Përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në sigurimin, ruajtjen, kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së ujit*”

5. Organizimi i fushatave kombëtare sensibilizuese, sipas ditëve të shëndetit të përcaktuara në kalendarin e promocionit të shëndetit.

- Dizenjimi dhe organizimi i pjesës më të madhe të ditëve/javëve/muajve të shëndetit:

- Dita Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë
- Java e Sigurisë Rrugore
- Dita Botërore e Mjedisit
- Dita Botërore e Perkuajtimit të Viktimave të Trafikut Rrugor
- Aktiviteti fizik dhe sëmundjet kardiovaskulare
- Ndihma e shpejtë
- Dita Botërore e Shikimit
- Dita Botërore e dëgjimit
- Dita Botërore pa Duhan
- Dita Botërore Shëndeti Oral
- Dita Botërore e Melanomes
- Dita botërore e hepatitit
- Dita Botërore e të Moshuarve
- Dita Botërore e veshkave
- Dita botërore kundër kancerit
- Dita Botërore e luftes kundër Tuberkulozit
- Dita Botërore e HTA
- Dita Botërore e ndërgjegjësimit ndaj përdorimit të antibiotikëve.
- Dita Botërore e diabetit.
- “2 Prilli, Dita Botërore e Autizmit”
- Dita botërore e syndromes Down
- “Problemet që lidhen me varësinë dhe Abuzimin me Droga
- “10 Tetori, Dita Botërore e Shëndetit Mendor”
- “Dita Botërore të Parandalimit të Vetëvrasjeve”,
- “Dita Botërore e Alzheimerit”
- Dita Botërore e Infermierit
- Dita Ndërkombëtare e Jo-dhunës
- Dita ndërkombëtare kundër Abuzimit me Fëmijët
- Java botërore e ushqyerjes me gji
- Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Femrave
- Dita botërore e Asmës bronkiale
- Dita botërore e Talasemisë
- Dita Botërore e Hemofilisë
- Dita Botërore e HIV/AIDS

6. Pjesëmarrje aktive në media e anëtarëve të departamentit për të mbuluar çështje të ndryshme lidhur me promovimin e shëndetit, të tilla si:

- Si të mbrohemi nga ftohti, Kujdesi në ditët e nxehta, Kancerin e gjirit, ushqyerjen, aksidentet rrugore, shëndetin mendor, shëndeti i fëmijëve,

kontrasepsionin, diabeti, mosha e tretë, duhanin, alkoolin, dhuna ndaj fëmijëve, etj.

- **Pjesëmarrje në emisione televizive:**

- ✓ Pjesëmarrje në dokumentarin IN TV “Vetevrasja”, Mars 2016
- ✓ Emission në studio në TOP CHANNEL, “Varësia nga internet”, Maj 2016
- ✓ Intervistë tek Ora NEWS, “Ndikimi I vapës në problemet e shëndetit Mendor, Korrik 2016
- ✓ Intervistë tek 1 Televizion, “Keshilla për shëndetin mendor në stinën e veror”, Korrik 2016
- ✓ Intervistë tek UTV, “Shëndeti mendor dhe stina e nxehtë”, Gusht 2016
- ✓ Emission në Studio tek TEMA TV, “Shëndeti mendor tek fëmijët”, Shtator 2016
- ✓ Intervistë te 1 Televizion “Varesia nga interneti dhe ndikimi tek rritja e fëmijëve”, Shator 2016
- ✓ Emission në studio tek Radio Tirana, “Parandalimi I përdorimit të drogës” Nëntor 2016
- ✓ Emissioni i mëngjesit “Wake up” në TOP-CHANNEL për fushatën kundër duhanit
- ✓ Emissioni i mëngjesit “Wake up” në TOP-CHANNEL “Si të mbrohemi nga i ftohti”

7. **Pjesëmarrje dhe/ose organizime aktiviteteve shkencore të anëtarëve të departamentit (konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare).**

- Pjesëmarrje e gjithë departamentit në Konferencën ndërkombëtare të SHP, Maj 2016.
- Konferencë Ndërkombëtare “Sfidat e zhvillimit në një shoqëri në ndryshim, insight nga kërkimet me adoleshentë e të rinj”, Universiteti i Tiranës; Fakulteti i Shkencave Sociale, Titulli i kumtesës së mbajtur “Përdorimit i tepruar i internetit dhe pasojat në shëndetin mendor të adoleshentëve”, Dhjetor 2016.
- Kongresi i Neuroshkencave, Tiranë, 3 Dhjetor 2016, Titulli i kumtesës së mbajtur “Mediat sociale dhe shëndeti mendor i adoleshentëve”.
- Konferenca e II-te e Adiktologjisë dhe Toksikologjisë Klinike të Aplikuar, Tiranë 12 Nentorb 2016, “Studim eksplorues i arsyeve të përdorimit të drogës tek adoleshentët”.

- Trajnim nje javor ne Durres per Protokollet e Kujdesit Shendetesor Paresor dhe Paketen e “Home visits”.
- -Ne kuader te strategjise se sistemit shendetesor takime te vazhdueshme me grupin e punes te OBSH si edhe me grupin nderministror te ngritur per hartimin e kesaj strategjie.
- Pjesëmarrje në trajnimin dy ditor «Advokacia dhe lobimi për ndryshim social ».
- Dialog mbi politikat e parandalimit te keqtrajtimit te femijeve ne Shqiperi.
- Prezantim i gjetjeve te projektit “Health Academi”.
- Prezantim i gjetjeve te studimit te njohurive, qendrimave dhe praktikave ne perdorimin e antibiotikeve ne popullaten e pergjithshme (Tirane, Vlore, Shkoder).
- Pjesëmarrje në “Summer School in Public Health Policy, Economics and Management 2016”, në Lugano, Zvicër.
- Pjesëmarrje në takimin ndërkombëtar të rrjetit të HBSC, Stokholm, 15-17 Qershor 2016.
- Pjesëmarrje në takimin e katërt të rrjetit të personave fokal botëror për parandalimin e dhunës dhe dëmtimeve, Finlandë, shtator 2016.
- Pjesëmarrje në Konferencën Botërore “12th World Conference on Injury Prevention and Safety Promotion”, Finland 2016.
- Pjesëmarrje në takimin rajonal “Moving forward CEE/CIS regional follow-up workshop to the Training of Master Trainers in CEE/CIS”, Sofje, Bullgari, Tetor 2016.
- Organizim i “Takimit me aktorë përgjegjës për sigurimin, kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm” (korrik 2016).
- Organizim i takimit per diskutimin e Draft-Planit te Veprimit te Promocionit Shëndetësor 2017-2021.
- Pjesëmarrje në konferencën për kujdesin perinatal,
- Pjesëmarrje në konferencën kombëtare të Hemofilisë,
- Pjesëmarrje në workshopin 2 ditor “Ngritja e kapaciteteve & rritja e ndërgjegjësimit mbi kontrollin e integruar jokimik të mushkonjave në Shqipëri”,
- Pjesëmarrje në workshopin 2 ditor organizuar nga Ministria e Shëndetësisë “Cervical Cancer Screening”

8. Publikime ne revista shkencore

Shkrimi i artikullit “Parimet e ndërhyrjes për parandalimin e anemisë ferodeficitare tek gratë shtatzënë” në buletin e ISHP-së

9. Pasurim i website

- Pasqyrimi ne faqen e ISHP-se se çdo aktiviteti që ka zhvilluar Departamenti i Promocionit.
- Përgatitja e materialeve informative të çështjeve sipas ditëve të kalendarit të shëndetit.

10. Organizim konferencash

- Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetit Publik, Maj 2016

11. Mbështetja e edukimit në vazhdim në Shëndet Publik

Në kuadrin e edukimit në vazhdim janë plotësuar dosjet përkatëse të akreditimit dhe janë akredituar në QKEV disa trajnime të zhvilluara nga ISHP:

- Programi i trajnimit me personelin shëndetësor për tema të ndryshme shëndetësore, të organizuara nga Departamenti i EPSH
- Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetit Publik, Maj 2016.



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

DEPARTAMENTIT TE EPIDEMIOLOGJISE DHE SISTEMEVE SHENDETESORE (DESiSH)

➡ INFORMACIONI SHENDETESOR

- marrja e informacionit shendetesor **nga te gjitha burimet e mundshme,**
- analiza e informacionit shendetesor dhe **PRODHIMI I INDIKATOREVE SHENDETESORE** (SIPAS GRUPEVE/TAKEMEVE PERKATESE),

ne kuadrin e aktivitetit te OBSERVATORIT KOMBETAR EPIDEMIOLOGJIK.

➔ (Ri)PERKTHIMI NE SHQIP, REDAKTIMI, DHE EDITIMI PER BOTIM NE SHQIP I ICD-10 (VELLIMI 1, VELLIMI 2) TE OBSH.

➔ EPIDEMIOLOGJIA E SEMUNDJEVE KRONIKE (JO-INFECTIVE) DHE KERKIMI MBI POLITIKAT SHENDETESORE.

➔ EPIDEMIOLOGJIA E SHENDETIT RIPODHUES:

(i) SURVEJANCA E ABORTIT;

(ii) SURVEJANCA E DEFЕКТЕВЕ TE LINDURA;

(iii) PROGRAMI LMIS I KONTRACEPTIVEVE.


➔ QENDRA KOMBETARE E SISTEMIT TE INFORMACIONIT PER DROGEN

➔ Perfshirje ne aktivite nderkombetare dhe pjesemarrje ne aktivite nderkombetare.



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

Paraqitja e drejtimeve të mesipërme të aktivitetit të DESiSH është bërë në përputhje me strukturën (organigramën) ekzistuese (viti 2016) të tij, që jepet skematikisht në vijim.



- I - SEKTORI “OBSERVATORI KOMBETAR EPIDEMIOLOGJIK”

GRUMBULLIMI (MARRJA) E INFORMACIONIT SHENDETESOR

DHE

PRODHIMI I

(I) INDIKATOREVE SHENDETESORE

(II) INDIKATOREVE DEMOGRAFIKE

(III) INDIKATOREVE SOCIAL-EKONOMIKE ME NDIKIM NE SHENDET

DHE

(IV) (Ri)PERKTHIMI, REDAKTIMI DHE EDITIMI PER BOTIMIN NE SHQIP I ICD-10 TE OBSH

(VELLIMI 1 [RRETH 1100 FAQE], VELLIMI 2 [RRETH 270 FAQE])

1. Semundshmeria Infektive

Objektivi

Grumbullim periodik nga Departamenti i Epidemiologjise dhe Kontrollit te Semundjeve Infektive (DEKSI), ISHP, i te dhenave mbi semundshmerine infektive, te raportuara periodikisht ne DEKSI nga te gjitha rrethet e vendit permes komponenteve (sistemeve) perberes te Sistemit te Integruar te Survejances te Semundjeve Infektive (SISSI), dhe te analizuara ne ate Departament.

Departamenti i Epidemiologjise dhe Sistemeve Shendetesore (DESiSH) merr nga DEKSI pikerisht ato te dhena te analizuara nga DEKSI qe sherbejne si bazament per prodhimin e niveleve te standardizuara te semundshmerise infektive te perftuar nepermjet SISSI.

Rezultati:

Prodhim i indikatoreve shendetesore perkates mbi bazen e te dhenave mbi semundshmerine infektive te perftuar nepermjet SISSI prej DEKSI te ISHP.

2. Semundshmeria Kronike Jo-Infektive

Objektivi:

- i. Grumbullim periodik i te dhenave ambulatorie (jo spitalore) te semundshmerise kronike per prodhimin e indikatoreve perkates.
- ii. Grumbullim periodik i te dhenave spitalore (nivel dytesor dhe tretesor) te semundshmerise kronike per prodhimin e indikatoreve perkates.
- iii. Grumbullimi i te dhenave te semundshmerise kronike nga kujdesi shendetesor paresor (mjeket e familjes), njeheresh nga Qendrat Shendetesore dhe nga FDSKSH (ish ISKSH).

Aktiviteti:

- i. Grumbullim nga Ministria e Shendetesise (MSH) i te dhenave spitalore per secilin vit per periudhen 2001-2015, vecse jo ne trajte elektronike.

- ii. Analiza e te dhenave dhe perftimi i niveleve krude dhe niveleve te standardizuara (popullata e botes si popullate standarde) te semundshmerise se pergjithshme dhe semundshmerise gjini-specifike, moshe-specifike dhe shkak-specifik per vitet 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015 te semundshmerise kronike spitalore.
- iii. Grumbullimi i te dhenave te semundshmerise kronike nga kujdesi shendetesor paresor (mjeket e familjes), njeheresh nga Qendrat Shendetesore dhe nga FDSKSH (ish ISKSH) pergjate periudhes 2007-2015.
- iv. Analiza e te dhenave dhe perftimi i niveleve krude dhe niveleve te standardizuara (popullata e botes si popullate standarde) te semundshmerise se pergjithshme dhe semundshmerise gjini-specifike, moshe-specifike dhe shkak-specifik per vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015 te semundshmerise kronike ambulatorore.

Rezultati:

- i. Prodhimi i indikatoreve perkates te semundshmerise spitalore krude dhe te standardizuar, te pergjithshme dhe gjini-specifike, moshe-specifike dhe shkak-specifik per vitet 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014.
- ii. Prodhimi i indikatoreve perkates te semundshmerise ambulatorore krude te pergjithshme shkak-specifike per vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015.

Mangesi (qe duhen eliminuar):

- i. Veshtiresi (arsye objektive) ne grumbullimin e te dhenave ambulatorore (Kujdesi Shendetesor Paresor) mbi semundshmerine kronike jo-infektive per arsye te mangesive ne funksionimin e sistemit te informacionit per kete qellim, si rrjedhoje e mos-arritjes ende te lidhjes se marrjes me rruge elektronike te te dhenave nga serveri i Fondit [ish Institutit] te Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor (FDSKSH) ne data warehouse (serverin) e ISHP.
- ii. Raportim i te dhenave spitalore (nivel dytesor dhe tretesor) mbi semundshmerine jo-infektive vetem ne Ministrine e Shendetesise – MSH (Sektori i Statistikes, Drejtoria e Shendetit Publik), dhe jo njeheresh (paralelisht) edhe ne ISHP.

Kjo mangesi duhet eliminuar.

- iii. Veshtiresite e aksesit te ISHP ne database te Sektorit te Statistikes ne MSH. Per rrjedhoje, te dhenat merren nga ISHP ne trajte leter, burim ky i nje vellimi te madh pune per hedhjen e ketyre te dhenave ne kompjuter.

Kjo mangesi duhet eliminuar.

- iv. Mangesi sasiore dhe te meta cilesore ne informacionin ekzistues ne database te Sektorit te Statistikes ne MSH lidhur me semundshmerine spitalore per vitet 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Eshte fjala konkretisht per mangesi dhe boshlleqe sasiore dhe cilesore lidhur me burimet e te dhenave [=QSUT, spitalet rajonale, spitalet e rretheve] dhe entitetet nozologjike [grup-semundje] qe duhen raportuar.

Kjo dukuri dikton urgjencen per eliminimin e saj.

3. Vdekshmeria e pergjithshme

Objektivi:

Grumbullim nga botimi perkates i Institutit te Statistikes (INSTAT) i te dhenave *vetem te agreguara* mbi vdekshmerine e pergjithshme per vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015, perpunimi sekondar i tyre, dhe prodhimi i indikatoreve perkates te vdekshmerise se pergjithshme ne total dhe gjini-specifike, moshe-specifike, shkak-specifike, si dhe sipas ndarjes urban-rural dhe asaj administrative (shkalle qarku).

Aktiviteti:

- i. Grumbullim nga botimet online (website i INSTAT) i te dhenave te vdekshmerise se pergjithshme per secilin vit te periudhes 2010-2015.
- ii. Analiza e te dhenave dhe perftimi i niveleve krude dhe niveleve te standardizuara (popullata e botes si popullate standarde) te vdekshmerise se pergjithshme dhe vdekshmerise gjini-specifike, moshe-specifike dhe shkak-specifik per periudhen 2001-2009.

Rezultati:

Prodhimi i indikatoreve perkates te vdekshmerise krude dhe te standardizuar, te pergjithshme dhe gjini-specifike, moshe-specifike dhe shkak-specifik, si dhe sipas ndarjes urban-rural dhe asaj administrative (shkalle qarku). per periudhen 2010-2015.

Mangesi per t'u eliminuar:

- i. Pamundesi (arsye ligjore) per akses te ISHP ne database qendrore per perftimin e te dhenave mbi vdekshmerine ne nivel individual (=skeda e vdekjes).
- ii. Varferia e te dhenave mbi vdekshmerine ne botimet zyrtare online (website) te INSTAT, qe jane burimi i vetem i informacionit per ISHP ne kete drejtim lidhur me vdekshmerine per periudhen 2010 e pas (konkretisht 2010-2015). Rrjedhimisht, pamundesia jone e validimit te te dhenave te agreguara nga INSTAT, si dhe pamundesia jone per prodhimin e setit (takemit) te plote te indikatoreve te vdekshmerise konform kerkesave te OBSH dhe Eurostat.
- iii. Mungese e botimeve vjetore te INSTAT per vdekshmerine me 2010 e pas.

4. Shendeti riprodhues (vdekshmeria foshnjore, vdekshmeria femijenore, vdekshmeria amesore)

Objektivi:

- i. Grumbullimi periodik nga MSH dhe INSTAT i te dhenave *vetem te agreguara* mbi
 - vdekshmerine foshnjore <1vjeç,
 - vdekshmerine femijenore 1-4 vjeç, dhe
 - vdekshmerine amesore.
- ii. Perpunimi sekondar i te dhenave te mesiperme dhe prodhimi i indikatoreve shendetesore perkates.

Aktiviteti dhe Rezultati i perftuar:

- i. Grumbullimi nga MSH dhe INSTAT i te dhenave mbi vdekshmerine foshnjore (< 1 vjeç) per secilin vit pergjate periudhes 2010-2015.
- ii. Krahاسimi i niveleve te perftuara te vdekshmerise foshnjore nga MSH me ato te perftuara nga INSTAT ne shkalle qarku dhe vendi, dhe i trendeve perkatese pergjate kesaj periudhe kohe (2010-2015).

- iii. Perftimi i niveleve te vdekshmerise foshnjore sipas ndarjes muaj-moshore: neonati i hershem, neonati i vonshem, postneonati ne shkalle qarku dhe vendi, dhe i trendeve perkatese pergjate kesaj periudhe kohe (2010-2015).
- iv. Perftimi i niveleve te vdekshmerise foshnjore sipas shkaqeve (=vdekshmeria shkak-specifike) ne shkalle qarku dhe vendi per vitin 2015.
- v. Grumbullimi nga INSTAT i te dhenave mbi vdekshmerine femijenore (1-4 vjec) per secilin vit pergjate periudhes 2010-2015.
- vi. Perftimi i niveleve perkatese ne shkalle qarku dhe vendi dhe i trendeve pergjate kesaj periudhe kohe (2010-2015).

Mangesi:

- i. Pamundesi (arsye ligjore) per akses te ISHP ne database qendror te INSTAT per perftimin e te dhenave mbi vdekshmerine ne nivel individual (=skeda e vdekjes). Rrjedhimisht, mosrealizim i validimit nga ISHP i te dhenave te agreguara nga INSTAT.
- ii. Pamundesia e aksesit te ISHP ne database te Sektorit te Statistikes ne MSH.

5. Demografia

Objektivi:

Grumbullim periodik nga INSTAT i te dhenave demografike per prodhimin e indikatoreve perkates demografike sipas Manualit te Indikatoreve Shendetesore Europiane. Grumbullim i ketyre te dhenave edhe nga MSH dhe ISHP si burime alternative, ndonese te karakterit operativ.

Rezultati:

- i. Prodhimi i indikatoreve demografike per vitin 2015 sipas Manualit te Indikatoreve Shendetesore Europiane dhe perftimi i piramides perkatese te popullates bazuar ne te dhenat e INSTAT.
- ii. Evidentimi i ndryshimeve sasore ndermjet te dhenave te INSTAT dhe atyre te MSH dhe ISHP, vecanerisht lidhur me kohort-lindjet dhe moshat femijenore.

Mangesi:

Pamundesi (arsye ligjore) per akses te ISHP ne database qendror te INSTAT per perftimin e te dhenave mbi lindshmerine ne nivel individual (=skeda e lindjes).

Rrjedhimisht, mosrealizim i validimit nga ISHP i te dhenave te agreguara nga INSTAT.

6. Indikoretet sociale-ekonomike me impakt ne shendet

Objektivi:

Grumbullim periodik nga INSTAT (si edhe MSH, MAS dhe ministri te tjera perkatese te linjes) i te dhenave social-ekonomike per prodhimin e indikatoreve perkates social-ekonomike me impakt ne shendet sipas Manualit te Indikatoreve Shendetesore Europiane.

Rezultati:

Prodhimi i indikatoreve perkates social-ekonomike me impakt ne shendet, konkretisht:

- i. Treguesit e të ardhurave ne nivel individual dhe njesi familje.
- ii. Punesimi dhe papunesia, si dhe te punësuar në lidhje me barrëlindjen.
- iii. Paaftësia e përkohshme në punë për shkak të sëmundjes.
- iv. Sëmundjet profesionale dhe aksidentet në punë.
- v. Tregues te ndryshem ne lidhje me moshën e trete, invaliditetin, humbjen e mbajtësit të familjes, papunësinë dhe personat e tjerë ekonomikisht aktivë, sjelljet e shëndetshme, etj.

7. (Ri)Perkthimi, Redaktimi dhe Editimi (nga Eduard Kakarriqi) per botimin ne shqip i ICD-10 te OBSH

dy velleme:

- Vellimi 1 [rreth 1100 faqe],
- Vellimi 2 [rreth 270 faqe],

Objekti:

(Ri)Perkthimi, Redaktimi dhe Editimi per botimin ne shqip i ICD-10 te OBSH;

dy nga tre vellemet, konkretisht:

- Vellimi 1 [rreth 1100 faqe],
- Vellimi 2 [rreth 270 faqe],

(Vellimi 3, Indeksi i Lendes, u konsiderua i tepert per t'u realizuar ne shqip.)

Rezultati:

ICD-10 ne shqip, e (ri)perkthyer, redaktuar dhe edituar, u dorezua ne OBSH (Zyra lokale per Shqiperine) si material krejtesisht i gatshem per t'u futur ne botim.

ICD-10 ne shqip u botua ne dhjetor 2016 (Shtepia Botuese 'Pegi') ne 1500 kopje, me format dhe cilesi botimi te njejte me origjinalin anglisht.

Pritshmeria per vitin 2016:

- 1) Pergatitja nga MSH e planit te veprimit per trajnimin e tere personelit shendetesor te vendit tone me ICD-10;
- 2) Realizimi i futjes ne perdorim ne Shqiperi i ICD-10 (ne vend te ICD-9 te deritanishme, qe, nga ana e vet eshte jo vetem e tejkaluar si kohe, por edhe me mangesi e boshlleqe lidhur me kerkesat aktuale te diagnozes klinike ne mjekesine klinike).

- II - SEKTORI

“EPIDEMIOLOGJIA E SEMUNDJEVE KRONIKE DHE KERKIMI MBI POLITIKAT SHENDETESORE”

1. Mbeshtetje teknike per rritjen e kapaciteteve ne fushen e depistimit te kancereve (kanceri i gjirit dhe kanceri i qafes se mitres)

Synimi kryesor i aktiviteteve te parashikuara gjate ketij viti (2016) ka qene pergatitja e nje kursi trajnimi per personelin e kujdesit shendetesor paresor dhe pilotimi i nje programi te organizuar depistimi lidhur me kancerin e qafes se mitres ne disa qendra shendetesore te perzgjedhura ne Tirane e Fier (Farke, Fier qytet dhe Libofshe). Baza teknike per kete nderhyrje jane udhezuesit dhe protokollet teknike te depistimit ne kujdesin shendetesor paresor qe u pergatiten nje vit me pare.

Ne fushen e aktiviteteve te kancerit te gjirit nje prioritet tjetër ka qene funksionimi ne vijimesi i nje sherbimi te mamografise mobile (te levizeshme).

Konkretisht:

- i. U pergatiten kurikula dhe materialet e trajnimit per kursin tre-ditor te trajnimit mbi depistimin e kancerit te qafes se mitres per personelin e kujdesit shendetesor paresor. Kursi u akreditua me 16 kredite nga QKEV. Dy kurse te tilla u kryen ne maj (Tirane) dhe qershor (Fier). Gjithsej rreth 90 mjeke dhe infermiere moren pjese ne trajnim.
- ii. U furnizuan me kite HPV, u pajisen me materiale te tjera teknike (algoritmet, ftesat per grate dhe skedat individuale per sistemin e informacionit) dhe u instruktua personeli mbi detajet e organizimit te punes ne klinike dhe komunitet si dhe bashkepunimin me laboratorin dhe hallkat me te larta ne sistemin referimit.
- iii. U kryen nje numer vizitash monitoruese ne 4 qendrat e perzgjedhura shendetesore dhe u pergatit database per skeden individuale te re. Ne peridhen korrik-dhjetor rreth 1100 gra u informuan permes ftesave, rreth 500 analiza u kryen perfshire dhe pergjigjen per çdo grua, rreth 600 teste depistuese jane ne proces dhe planifikohet te vijohen ne dy muajt e ardhem me rreth 1000 teste te tjera.
- iv. Bazuar edhe ne eksperiencen e fituar gjate ketij pilotimi, u pergatit nje dokument teknik mbi orientimin e politikave te Ministrise se Shendetesise ne fushen e depistimit te kancerit te qafes se mitres per vitin e ardhshem dhe ne vazhdim.
- v. Eshte pergatitur ne bashkepunim me Qendren e Piemontit (Itali) mbi Depistimin e Kancereve (qender bashkepunuese e OBSH ne kete fushe) si dhe Institutin e Shendetit Publik te Malit te Zi, nje studim mbi qasjet me te pershtatshme per ftesen e grave ne programet e depistimit. Jane skicuar gjithë elementet dhe pritjet te filloje puna ne praktike.

- vi. Ne vijim te punes se filluar gjate vitit 2015 ka vazhduar te ofrohet sherbimi i organizuar sipas nje plani te aprovuar i mamografise, permes 2 njesive te mamografise se levizeshme. Jane vizituar mbi 18 qytete ne 15 rrethe te vendit ku nuk ka sherbime te mamografise. Jane depistuar rreth 4800 gra te moshave 40-65 vjec, duke e dyfishuar keshtu numrin total te mamografive te kryera ne sistemin publik ne Shqiperi ne nje vit. Eshte menaxhuar ne te njejten kohe puna pergatitore ne bashkepunim me DSHP-te e rretheve dhe jane pergatitur ne kohe reale raportet monitoruese te publikuara ne website e ISHP.
- vii. Eshte bashkepunuar me sherbimet private (BSN) per interpretimin e mamografive te kryera.
- viii. Ne bashkepunim me departamente te tjera te ISHP dhe me MSH eshte mbeshetur fushata mbi kancerin e gjirit ne tetor 2016.
- ix. Ka vijuar bashkepunimi i metejshem me Institutin e Kancerit “Regina Elena” ne fushen epidemiologjike, mbi studimin e tipave te HPV-se qe qarkullojne ne Shqiperi. Jane marre mostrat ne bashkepunim me qendrat shendetesore dhe QSUT dhe jane duke u analizuar rezultatet vjetore.

2. Mbeshtetje teknike per permiresimin e sistemit te regjistrave te kancerit

- i. U miratua marreveshja e shkembimit te informacionit mbi kanceret mes ISHP dhe gjithe spitaleve universitare.
- ii. Per here te pare, bazuar ne kete marreveshje (lidhur me VKM mbi raportimin e semundjeve 2014), ka filluar grumbullimi i informacionit nga QSUT “Nene Tereza”, Spitali Pneumoftiziatrik, dhe dy spitalet obstetrike-gjinekologjike, sipas karteles se re individuale te standardizuar.
- iii. Eshte menaxhuar kompjuterizimi i te dhenave per shumicen e ketij informacioni te ri per ISHP.
- iv. Nuk u arrit te aprovohej projekti i mbeshetjes per regjistrin e kancerit nga ana e IAEA, megjithe pergatitjen e gjithe dokumentacionit te kerkuar.

3. Aktivitete kerkimore dhe keshilluese per MSH ne fushen e politikave te semundjeve jo te trasmetueshme (perfshi kanceret)

- i. Ne mbeshetje te Ministrise se Shendetesise eshte punuar ne kuader te grupit te punes dhe komitetit kombetar te semundjeve jo te trasmetueshme per finalizimin e strategjise kombetare dhe planit te veprimit perkates. Ne Tetor 2016 keto dokumenta u miratuan me urdher te Ministrit.
- ii. Ne bashkepunim me nje specialist te huaj ne kuader te programeve te bashkepunimit shkencor, eshte punuar gjate periudhes shtator-dhjetor dhe

ndodhet ne faze perfundimtar nje analize e situates lidhur me barren e kancerit kolorektal dhe kancerit te stomakut ne Shqiperi si dhe kapacitetet per kontrollin e tyre.

- iii. Eshte realizuar ne janar, shkurt dhe tetor mbeshtetje ndaj MSH ne fushatat ndergjegjesimit mbi parandalimin dhe kapje e hershme te kancereve.
- iv. Po ashtu, eshte realizuar pergatitje materialesh teknike, trajnime, koordinim i punes me institucione te tjera per kryerjen e ekzaminimeve dhe interpretimin e tyre.

4. Aktivitete ne fushen e fuqizimit te kontrollit te semundje te tjera kronike

- i. Eshte bere rishikimi i regjistrave të sëmundjeve ishemike të zemrës dhe sëmundjeve ishemike të trurit.
- ii. Eshte kryer pilotimi i regjistrave për sëmundjet ishemike të zemrës dhe sëmundjet ishemike të trurit në spitalin rajonal te Durrësit ne kuadrin e krijimit te Sistemit te Survejances te Semundjeve Kardio-Cerebro-Vaskulare ne Shqiperi. Jane kryer disa takime tekniko-organizative ne spitalin rajonal te Durresit dhe qendra te tjera te ofrimit te sherbimeve ne Durres.
- iii. Ne kuadrin e Sistemit te Survejances te Semundjeve Kardio-Cerebro-Vaskulare jane kryer takime tekniko-organizative ne spitalet rajonale te Elbasanit, Korçes, Dibres, Kukesit, Fierit, dhe sherbimet spitalore te rretheve perkatese te rajoneve te lartpermendura (Elbasan, Korçe, Diber, Kukes, Fier).
- iv. Ne kuadrin e Sistemit te Survejances te Semundjeve Kardio-Cerebro-Vaskulare jane kryer takime tekniko-organizative ne Drejtorite e Shendetit Publik (me fokus Sherbimin e Kujdesit Shendetesor Paresor) te Elbasanit, Korçes, Dibres, Kukesit, Fierit.
- v. Ka filluar mbledhja sistematike e informacionit mbi infarktin e miokardit sipas skedave te miratuara dhe eshte realizuar vleresimi i cilesise se te dhenave.
- vi. Ne kuadrin e Programit Kombetar te ‘Check up’, eshte pergatitur ne grup pune te miratuar nga Ministri i Shendetesise, protokolli i referimit per gjithë rastet pozitive te kapura nga ky program kombetar i MSH mbi sherbimet baze per moshat 40-65 vjec (‘check-up’) per testin ‘gjak okult pozitiv ne feçe’. Nderkohe, eshte kryer analiza e te dhenave te ‘check up’ per rastet te rezultuara pozitiv per testet e heparit (AST dhe ALT).
- vii. Eshte pergatitur nje analize e sistemeve te informacionit mbi monitorimin dhe vleresimin e semundjeve kronike ne Shqiperi si dhe matrica e plote e indikatorëve per t’u perdorur ne kete fushe ne vendin tone. Dokumenti eshte shoqeruar me metadaten e plote perkatese, sipas modeleve te OBSH (rreth 50

faqe). Ky dokument do të shërbejë vec të tjerash edhe si komponente e monitorimit dhe vleresimit të strategjisë së sëmundjeve kronike në Shqipëri.

- viii. Në bashkëpunim me MSH dhe grupin multisektoral të punës të ngritur për këtë qëllim është finalizuar drafti i strategjisë së parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve kronike si dhe plani i detajuar i veprimit për kontrollin e tyre në Shqipëri (rreth 50 faqe), që u miratuan nga Ministri i Shëndetësisë. Kjo strategji kryhet për herë të parë në vendin tonë.
- ix. Në bashkëpunim me Departamentin e Promocionit Shëndetësor në ISHP si dhe partnere të tjerë janë organizuar aktivitete sistematike dhe fushata ndergjegjëse lidhur me parandalimin pasor apo me kapjen e herëshme të sëmundjeve kardiovaskulare, sëmundjeve cerebrovaskulare, kancerëve, diabetit, sëmundjeve të veshkave, etj.
Jane përgatitur materialesh për publikun e gjërë, pjesëmarrje në programe televizive, si dhe konferenca dhe aktivitete të tjera ndergjegjëse.

5. Aktivitete kerkimore ne fushen e semundjeve kronike dhe shendetit te te moshuarve

Është perfunduar puna në terren lidhur me fazën e tretë (follow up) të studimit nderkombetar multicentrik IMIAS mbi mobilitetin, shëndetin mendor dhe sëmundjet kronike tek një kampion të moshuarish të Tiranës. Janë bërë nderkohe publikime në revista (6 publikime) dhe konferenca nderkombetare (10 prezantime) mbi rezultatet e fazave të mëparshme.

6. Projekt kerkimor mbi vleresimin e teknikave te matjes se obezitetit dhe aktivitetit fizike mes femijeve

Në bashkëpunim me IAEA ka filluar një projekt kerkimor mbi vleresimin e teknikave të matjes së obezitetit dhe aktivitetit fizikë mes fëmijëve. Objektivi është validimi i matjeve antropometrike të kryera në mënyrë rutine në Shqipëri përmes përdorimit për herë të parë në vend të teknikave të standardit të arte në një kampion të vogël fëmijësh. Është përgatitur protokoli, është realizuar takimi i parë dhe është ngritur grupi i punës në bashkëpunim me departamentet e tjerë në ISHP. Planifikohet që në mars të 2017 të zhvillohet workshopi nderkombetar me këtë qëllim.

7. Aktivitete te tjera

- i. Përgatitje sistematike e raporteve monitoruese për Ministrinë e Integritetit lidhur me programet e zhvillimit dhe përparimin e kryer në fushat e depistimit të kancerëve dhe kontrollit të drogave.
- ii. Mbeshtetje për ISHP dhe MSH me monitorim, ekspertizë dhe hetim epidemiologjik kur ka qenë e nevojshme.

- III - SEKTORI
“KERKIMI NE POPULLATE”

= EPIDEMIOLOGJIA E SHENDETIT RIPRODHUES

1. SURVEJANCA E ABORTIT

Aktivitetet e kryera me 2016 ne kuadrin e Survejances se Abortit (nje nder aspektet e fushes se larmishme te “Epidemiologjise se Shendetit Riprodhues”):

1. Eshte kryer koordimi i punës në gjithë vendin lidhur me Sistemin e Survejancës së Abortit, grumbullim periodik nga gjithë maternitetet dhe spitalet private të licensuara për ndërprerje shtatzënie, analizim dhe monitorim i ecurisë mbi abortet, si dhe përpilim i raportit vjetor mbi abortet në vend, një kopje e të cilit dërgohet në Ministrinë e Shëndetësisë – MSH.
2. Eshte pergatitur nje raport i detajuar shkencor mbi abortet ne Shqiperi pergjate periudhes 2010-2015. Raporti, ne trajte artikulli shkencor eshte derguar edhe per botim ne AMJ.
3. Të dhënat mbi abortet në vend (disa në format elektronik), derguar në ISHP nga personat përgjegjës për survejancën e abortit (Inspektorët e Shëndetit Riprodhues), jane hedhur në databasen kombetare te të dhënave të Tiranës dhe klinikave private, dhe eshte bere analizimi i tyre në programin statistikor SPSS e më tej përpunimi i raportit vjetor dhe përpilimi i indikatorëve lidhur me abortet.
4. Jane kryer monitorime të vazhdueshme (çdo tre muaj) në të dy maternitetet e Tiranës (Spitali Obstetrik-Gjinekologjik ‘Mbreteresha Geraldine’ dhe Spitali Obstetrik-Gjinekologjik ‘Koco Gliozheni’) mbi ecurinë e raportimit të skedave të abortit, kontrollin e rasteve në regjistrat e abortit, si dhe plotësimin e saktë të skedës nga ana e mjekëve.

2. SURVEJANCA E DEFЕКТЕВЕ ТЕ LINDURA

Sfidat dhe veshtiresite qe vijojne te ndeshen ne funksionimin e Survejances se Defekteve te Lindura ne Shqiperi konsistojne permbledhtas ne nenraportim te Defekteve te Lindura (nepermjet Skedes se Defekteve te Lindura) per arsye se:

- a - Mjeket specialiste neglizhojne te plotesojne Skeden e Defekteve te Lindura;
- b – Specialistet e shendetit publik ne rrethe neglizhojne ne mbledhjen e skedave te defekteve te lindura dhe ne rakordimin e skedave te raportuara me numrin real te defekteve te lindura te regjistruara ne spitale dhe qendra shendetesore.

Aktivitetet e kryera me 2016 ne kuadrin e Survejances se Defekteve te Lindura (nje nder aspektet e fushes se larmishme te “Epidemiologjise se Shendetit Riprodhues”):

1. Eshte kryer koordinimi dhe menaxhimi i Sistemit te Survejancës së Defekteve të Lindura, dhe, në mënyrë më specifike: grumbullimi i të dhënave, hedhja e të dhënave në databazë, analizimi i të dhënave, nxjerrja e rezultateve për vitin 2015, shkrimi i raportit dhe dërgimi i raportit në Ministrinë e Shëndetësisë.
2. Eshte pergatitur (ne shqip dhe anglisht) Raporti mbi Survejancen e Defekteve te Lindura per periudhen 2011-2015, bazuar ne modelin e raportimit perkates te CDC dhe OBSH.
7. One health approach gap analysis of leishmaniasis detection, prevention and response in the Republic of Albania. P.20.184. International Meeting on Emerging Diseases and Surveillance, 4- 7 Nentor, Vienna, Austria.
 8. Gap analysis of leishmaniasis detection, prevention and response lessons learned for vector borne diseases in Albania, Jordan and Pakistan. P.20.185 International Meeting on Emerging Diseases and Surveillance, 4-7 Nentor, Vienna, Austria.
 9. WHO Burden of Influenza Disease Meetings in Geneva, Switzerland: 12-14 July 2016 – Prezantim Poster
 10. Abstrakte per Konferencen e V-Te te Mikrobiologjise
 11. “The current status of phlebotomine sand flies in Albania and incrimination of *phlebotomus neglectus* (Diptera, Psychodidae) as vector of *leishmania infantum*”. The 3rd Conference on Neglected Vectors and Vector-Borne Diseases of the COST Action TD1303. Abstract book pg. 139. Zaragoza Spanje.
 12. ‘Hemorrhagic fever with renal syndrome and leptospirosis, potential rodent-borne infectious diseases in Albania’. The 3rd Conference on Neglected Vectors and Vector-Borne Diseases of the COST Action TD1303 Abstract book pg. 113.
 13. “Nje rishikim i shkurter mbi rastet e njerezve me leptospiroze ne Shqiperi 2010-2013”. Konferenca: “Te mbrojme shendetin publik petej kufijve”, Marakesh, Marok.
 14. Detection of different enteric protozoal parasites with combination of immunological and microscopic methods, in Albania. 2nd International Conference on Parasitology August 01-03, 2016. Manchester, UK.
 15. A survey of canine leishmaniosis in Albania. Conference EurNegVec, 24-26 May 2016.
 16. The current status of phlebotomine sand flies in Albania and incrimination of *phlebotomus neglectus* (diptera, psychodidae) as vector of *leishmania infantum*. Conference EurNegVec, 24-26 May 2016.

17. Respiratory Syncytial Virusinfection among hospitalized infants in low and middle income countries – Simpozium i 10-te nderkombetar i RSV, Patagonia, Argentine.
18. Measles & Rubella - NRL of Albania - WHO European Regional Measles/Rubella LabNet meeting for Russian Federation and Newly Independent States, 29 June –1 July 2016.Budva, Montenegro

I. Probleme dhe mungesa:

1. Ka mungesa ne buxhet per te vleresuar sistematikisht sistemin ALERT dhe raportimin ne vend.
2. Ka mungese e nje linje te dedikuar celulare komunikimi me rrethet dhe nje telefoni celular te dedikuar per kete
3. Ka mungese te raportimit web based te sistemit teurvejancave.
4. Ka mungese te serumit anti botulizem i cili nuk eshte prokuruar.
5. Gjate vitit 2016 nuk jane ndjekur te gjitha hapat e planit te veprimit te kontrollit te infeksioneve spitalore sipas parashikimeve te vitit 2016 .Eshte kryer vleresim i pjesshem i ngarkeses mikrobike vetem ne disa spitale te qarqeve ne vend ne kuader te sektorit te kontrollit te infeksioneve te kujdesit shendetesor. (Nderprerje e sherbimeve nga drejtoria).
6. Nuk eshte publikuar analiza e semundjeve infektive por eshte kryer vetem publikim i pjesshem i te dhenave ne buletin e ISHP.
7. Pamundesi supervizimi neper rrethe.
8. Vonesa te ardhjes se fletehyrjeve nga rrethet kryesisht te vaksines DTP e cila u terhoq vete nga DRSH/DSHP-te.
9. Pamundesi ne prokurimin e vaksinave te udhetareve , dhe per me teper pamundesia e blerjes se vaksines dhe serumit ndaj Rabies. Tenderi ka deshtuar dy here deri tani.
10. Rregullimi dhe mirembajtja e frigorifereve qendrore te vaksinave.

11. Mirembajtja e zinxhirit te ftohte ne rang vendi
12. Mungesa e nje makine te pershtatshme frigoriferike per shperndarjen e vaksinave
13. Mungesa te makinave te pershtatshme per punet ne terren.
14. Sherbimi logjistik i urgjences duhet te permiresohet qe te krijojte kushtet per pergjigjen e menjehershme.
15. Mungesa e numrave te telefonave celulare per komunikimin me rrethet.
16. Mungese e Labororit te Rodentologjise Mjekesore dhe nevoja per ngritjen e tij.
17. Sigurimi i pajisjeve manipuluese per kapjen, disekimin dhe ruajtjen e organeve dhe gjakut ne terren per brejtesit dhe insektivoret.
18. Sigurimi i makinave ne gjendje te mire per te kryer punen ne terren vecanerisht ne zonat e thella.
19. Ngritja e nje insektari per te krijuar mundesi te metejshme per zgjerimin e aktivitetit kerkimor-shkencor ne drejtim te vektoreve.
20. Pamundesi per trajnime te stafit mbi teknikat e izolimit te patogjeneve te vektoret.
21. Pamundesi per zbatimin e metodave te reja per diagnozen laboratorike te difterise.
22. Pamundesi per vendosjen e diagnozes laboratorike te kolles se mire.
23. Pamundesi per identifikimin dhe studimin e rezistences antimikrobike te shtameve rezistente te gonokokut.
24. Mos furnizimi me kite brenda afateve si dhe mos marrja parasysh per furnizim me kite per diagnozen e mykozave.
25. Mungese e kushteve te pershtatshme ne laboratorin e parazitologjise.
26. Probleme jane hasur ne lidhje me mosfunksionimin e disa prej frigorifereve te labororit te virologjise.
27. Mosfunksionim i kartes elektronike e cila ben te mundur hyrjen ne laboratorin e virologjise.
28. Mosfunksionimi i sistemit ftohes ne laboratorin e virologjise.

29. Demtim i tavanit te laboratorit BSL3 per shkak te lageshtise se krijuar gjate renies se shirave.
30. Moskryerja e ndrrimit te filtrave te kapave te sigurise biologjike.
31. Laboratori i virologjise eshte i vetmi laborator ne Shqiperi i cili kryen diagnozen e infeksioneve virale te tilla si Poliomieliti, gripi, virozat respiratore, Ethet hemorragjike virale, gastroenteritet me shkaktar viral, meningitet aseptike etj. Ky laborator perbehet nga 8 laborene ne te cilin kryhen aktivitetet te vecanta, lavanterine si dhe dhomen e autoclaves. Numri i aparaturave ne keto laborene eshte i madh. **Per kete arsye mirembajtja e tyre vjetore nga persona apo kompani te specializuara sipas rregullave te cilesise te percaktuara nga OBSH dhe ECDC eshte mjaft i rendesishem.**
32. Venia ne eficence e laboratorit te Nivelit te trete te Biosigurise, e cila eshte nje sfide e madhe per te gjitha ne pjese te ketij investimi te madh.
33. Duke qene se laboratori i virologjise eshte i pajisur me shume aparatura elektronike ne kerkojme qe te kete nje person (jo vetem per kete laborator po qe do ti sherbente te gjithëve) i cili te mirembaje keto aparatura here pas here ne menyre qe ato te mos ngelen stok ne magazine per dicka shume te vogel.
34. Mungesa e mundesise per te ndjekur kursete te trajnimit konkretisht per thellimin e njohurive te biologjise molekulare si psh karakterizimi gjentik te viruseve me ane te aparatures se sekuenciatorit

Historiku i krijimit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet si Inspektorat Shtetëror

Në zbatim të ligjit Nr.8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar dhe ligjit Nr.10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, është Autoriteti Kompetent kombëtar që mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe atij jojonizuese, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, ndërsa Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet përcaktohet si organ ekzekutiv i saj.

Amendimet e ligjeve Nr.26\2013, “Mbi disa ndryshime të Ligjit Nr.8025, datë 9.11.1995, për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar dhe 27\2013, “Mbi disa ndryshime të ligjit Nr.10469, datë 13.10.2011, për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, janë bërë në përputhje me Ligjin Nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe përcaktojnë se, Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këto ligje.

2. Detyrat e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet

Ligji Nr.8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, përcakton detyrat e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet, si më poshtë:

- a) Paraqet për miratim në komision aktet rregulluese të veprimtarisë së mbrojtjes nga rrezatimet.
- b) Kontrollon në praktikë zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.
- c) Kryen inspektimin e instalimeve dhe veprimtarive me rrezatim, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
- ç) Mbledh informacion dhe kryen matjet e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet.
- d) Përgatit dosjet për dhënien, pezullimin dhe heqjen e licencave dhe ia paraqet komisionit për miratim.
- dh) Përgatit materialet e mbledhjeve të komisionit, si dhe raportet e kërkuara prej tij.
- e) Mban inventarin kombëtar të burimeve të rrezatimit jonizues.

2. Këshilli i Ministrave përcakton rastet kur inspektorati që mbulon fushën e shëndetit kryen inspektime për zbatimin e rregullave të instalimeve apo veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, si dhe të mënyrës së bashkëpunimit të tij me Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimi.


Ligji Nr.10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, i ndryshuar përcakton se :

1. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet është njësi ekzekutive e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, e cila, përveç detyrave të përcaktuara në fushën e rrezatimit jonizues, kryen edhe këto detyra:

- a) Paraqet për miratim në komision aktet rregulluese të veprimtarisë së mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;
- b) Kontrollon në praktikë dhe mbikëqyr zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;
- c) Kryen inspektimin e instalimeve dhe veprimtarive me rrezatim jojonizues, në përputhje me ligjin për inspektimin;
- ç) Mbledh informacion dhe kryen matjet bazë e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;
- d) Përgatit dosjet për miratimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues;
- dh) Përgatit materialet e mbledhjeve të komisionit, si dhe raportet e kërkuara prej tij;
- e) Mban inventarin për të gjitha matjet e kryera kombëtare të instalimeve dhe regjistrat e posaçëm për të gjitha matjet e kryera.

2. Këshilli i Ministrave përcakton rastet kur inspektorati që mbulon fushën e shëndetit kryen inspektime për zbatimin e rregullave të instalimeve apo veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, si dhe të mënyrës së bashkëpunimit të tij me Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimi.

Organograma ZMR



3. Misioni i Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, si Autoriteti Kompetent Kombëtar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese dhe Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet si organ ekzekutiv, është të përcaktojë kushtet e mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, të popullatës dhe mjedisit, në tërësi, nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive, duke shfrytëzuar, në maksimum, të mirat që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese.

KMR-ja dhe ZMR-ja ka si mision kontrollin e ekspozimeve të publikut dhe të punonjësve, si dhe monitorimi i rrezatimeve jojonizuese, duke shfrytëzuar të mirat që vijnë nga përdorimi i tyre

4. Deklarata e misionit

Mbrojtja e publikut, personelit dhe mjedisit nga rrezatimet, sot dhe për brezat e ardhshëm në Shqipëri, është një proces në vazhdimësi, i cili kërkon një punë intensive të Zyrës për Mbrojtjen nga Rrezatimet (ZMR) dhe të gjitha atyre institucioneve, të cilat janë të përfshira në këtë proces, që lidhet me mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues dhe kontrollin e ekspozimeve të publikut dhe të punonjësve, si dhe monitorimin e rrezatimeve jojonizuese.

Stafi i ZMR-së ka punuar si çdo vit në zbatim të funksioneve që japin ligjet për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese dhe misioni i tij ka qenë përgatitja e dokumenteve ligjore për mbrojtjen e punonjësve, publikut dhe mjedisit nga efektet e rrezatimeve, duke zhvilluar dhe krijuar sistemin e administrimit dhe kontrollit të mbrojtjes nga rrezatimet, në përputhje me standardet ndërkombëtare të ANEA-s dhe Bashkimit Evropian (BE), inspektimin e instalimeve dhe veprimtarive me rrezatim, në përputhje me ligjin Nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjet në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, proces i cili dhe gjatë këtij viti ka qenë një sfidë për inspektorët e ZMR-së, në radhë të parë përshtatja dhe kuptimi nga ana e tyre i gjithë dokumentacionit egzistues në përputhje me legjislacionin në fushën e inspektimit dhe më pas implementimi i tyre në praktikë.

Në zbatim të ligjit për inspektimin, Nr.10433 datë 16.06.2011, rregullores Nr.696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për mirmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, në funksion të këtij procesi ZMR-ja ka nxjerrë disa urdhëra të cilët lidhen me ndjekjen dhe plotësimin e programimeve mujore të inspektimit, përcaktimin e faktorëve të rrezikut, peshës dhe treguesve të tyre, përcaktimin e faktorëve dhe treguesve të efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriterëve të vlerësimit të tyre, si më poshtë:

Urdhër 15, i cili përcakton personin përgjegjës për ndjekjen dhe plotësimin e gjithë procedurës që lidhet me inspektimin

Urdhër Nr.16, për plotësimin e të gjitha rekomandimeve të lëna nga grupi i kontrollit.

Urdhër Nr.17, për zbatimin e formateve standarde për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Urdhër Nr.18, mbi përcaktimin e frekuencës kohore të inspektimit të veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues në bazë të rrezikut.

Urdhër Nr.19, për miratimin e rregullores së brendshme të ZMR-së në lidhje me inspektimin dhe në përputhje me ligjin për inspektimin.

ZMR-ja ka përfunduar dokumentacionin si më poshtë:

- Rregulloren e brendshme të ZMR-së, e cila është miratuar nga Kryetari i ZMR-së.
- Udhëzim për metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit nga inspektorët e ZMR-së
- Lista e kontrollit për radiologjinë
- Lista e kontrollit për burime të mbyllura
- Lista e kontrollit për burime të hapura
- Lista e kontrollit për transportin e materialeve radioaktive

5.Qëllimi

- ✓ Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet do të ketë si qëllim kryesor shtimin e vlerave të zyrës si inspektorat shtetëror, nëpërmjet një niveli sa më të lartë menaxhimi në mënyrë që të përmbushen pritshmëritë dhe nevojat.
- ✓ Gjithashtu ZMR-ja ka si qëllim identifikimin e rreziqeve që mund të vinë nga përdorimi i burimeve të rrezatimit jonizues nga persona të paautorizuar si dhe evidentimin në kohë në bashkëpunim me institucione të tjera përgjegjëse të ndonjë trafiku të mundshëm ilegal të burimeve të rrezatimit jonizues, apo të ndonjë aktiviteti tjetër të paligjshëm që lidhet me to.
- ✓ ZMR-ja do të kryejë të gjitha inspektimet në kohë dhe me saktësi, sipas programit vjetor të miratuar.
- ✓ ZMR-ja do të japë në kohë dhe cilësi të gjithë informacionin e duhur për vendimmarrësit.
- ✓ ZMR-ja do t'i japë rëndësi kontrolleve të brendshme në mënyrë përmirësimit dhe zbatimin e suksesshëm të veprimtarisë së zyrës.

Në këtë kuadër ka gjetur mbështetje dhe udhëzimi bazë për detyrat kryesore dhe objektivat e vitit 2016.

Detyrat kryesore dhe objektivat bazë për vitin 2016 ishin:

1. Mbledhje dhe sistemim i dokumentacionit për subjektet private dhe shtetërore, të cilët aplikojnë për marrjen e licencës, aktit të miratimit, si dhe vlerësimi i tyre.
2. Realizim inspektimesh sipas garfikut të miratur në KMR dhe aprovuar nga IQ-ja.
3. Pjesëmarrje në projektet e ANEA-s.

4. Përshtatja e legjislacionit tonë me atë të BE-së, sipas projektit me BE-në dhe plotësimi matricës bashkëngjitur.
5. Përditësimi i inventarit kombëtar i të gjithë burimeve të rrezatimit jonizues në RSH si dhe plotësimi i rubrikave të sistemit RAIS bazuar në Licencimin, Inspektimin, Import-Eksportet, Transportet e burimit të rrezatimit jonizues, si dhe numrin e punonjësve të ekspozuar profesionalisht (mars 2017, inventari i plotë i burimeve të rrezatimit jonizues si dhe punonjësve).
6. Instalimi i RAIS në version WEB, me mbështetjen e ISHP-së.
7. Plotësim dhe rishikim i faqes zyrtare të KMR-së dhe ZMR-së.
8. Rritje e nivelit tonë shkencor dhe profesional nëpërmjet kualifikimeve të ndryshme në seminare, trajnime si dhe me pjesëmarrjen në projektet që kemi në rang ndërkombëtar.
9. Realizimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit me vendet e rajonit.
10. Vazhdimi i procesit për pajisjen me aktmiratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues.
11. Përditësimi i inventarit të burimeve të rrezatimit jojonizues sipas modelit të miratuar në ZMR.
12. Përditësimi i të dhënave në sistemin RASIMS në lidhje me TSA-të dhe NSA-të, për të cilat ZMR-ja është përgjegjëse.
13. Përditësimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.
14. Mbledhja e të dhënave dhe sistemim i informacionit në lidhje me trafikun ilegal.

MATRICA E PARASHIKUAR PËR ZYRËN E MBROJTJES NGA RREZATIMET PËR VITIN 2016

1. Përgatitja e Vendimit të Këshillit të Ministrave "Rregullore për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë", Katërmujori i dytë.
2. Përgatitja e Vendimit të Këshillit të Ministrave "Rregullore për transportin e sigurtë të materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë", Katërmujori i tretë.

Në mbështetje të planit të punës, ku janë të përcaktuara detyrat kryesore dhe objektivat bazë, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka realizuar detyrat e përcaktuara me eficiencë dhe përgjegjshmëri. Këto detyra lidhen me procesin e pranimi të dokumentacionit të aplikuesve për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues dhe jojonizues; vlerësimin e aplikimeve për këto veprimtari, inspektimin bazuar në planin vjetor të inspektimit të kabineteve radiologjike dhe subjekteve që përdorin burime të hapura dhe të mbyllura në Republikën e Shqipërisë; aprovimin e import/eksporteve, transportin dhe transferimin e burimeve të rrezatimit jonizues, plotësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e tij me direktivat e BE-së, si dhe me standardet e ANEA-s .

Në zbatim të ligjit Nr.8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar, dhe ligjit Nr.10469, datë 13.10.2011, "Për mbrojtjen nga rrezatimet

jojonizuese”, i ndryshuar, shtyllat bazë ku mbështetet puna jonë janë: licencimi i veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, pajisja me aktmiratim të veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, inspektimi i subjekteve që kanë në përdorim burime të rrezatimit jonizues dhe sanksionet në rastin e shkeljeve të dispozitave ligjore.

LICENCIMI I VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMIT JONIZUES

Në zbatim të ligjit Nr.8025, datë 09.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, si dhe rregullores “Mbi licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues” Nr.10, datë 07.01.2010, procesi i licencimit ka vazhduar normalisht dhe gjatë këtij viti, që nga e faza e parë që është njoftimi deri në fazën e fundit që është miratimi ose jo i licencës.

Numri në total i aplikuesve për licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues gjatë vitit 2016, ka qenë 66, ku 35 prej të cilëve kanë aplikuar për rinovimin e licencës, 30 prej tyre kanë aplikuar për herë të parë dhe 1 subjekt ka amenduar licencën.

Subjektet e licencuara gjatë vitit 2016 janë si më poshtë:

1. Qendra Spitalore Universitare “ Nënë Tereza”, Mjekësia Bërthamore, Tiranë.
2. Spitali Rajonal dhe Poliklinika Berat (Graf/skopi, Mamografi, CT-Skaner)
3. Spitali “ Ismet Shushi”, Delvinë (Graf)
4. Spitali Rajonal Fier (Graf, CT-Skaner, Mamografi)
5. Spitali Rajonal dhe Poliklinika Vlorë (Graf, Skopi, CT-Skaner)
6. Spitali Përmet (Graf/ Skopi, Graf Dentare)
7. Spitali Krumë, Has (Graf/Skopi)
8. Spitali Pukë (Graf)
9. Spitali Sarandë (CT-Skaner, Graf, Skopi)
10. Spitali Kontinental, Tiranë (Graf, CT-Skaner, Mamografi, Litotript)
11. Remu Balkans, Durrës (Radiografi Industriale me rreze X)
12. Kompania “Eurochrome”, Kukës (Burim i mbyllur Cs-137)
13. Klinika Tona Dent, Korçë (Graf dentare dhe Panorameks)
14. Klinika Dentare Toti & Gurakuqi, Tiranë (Panorameks Cefalometri)
15. Grafia Dentare “ Galeria”, Tiranë (Panorameks Cefalometri dhe Graf Dentare)
16. Klinika e Imazherisë “ Golloshi”, Tiranë (Panorameks, graf dentare, Graf)
17. Kompania “Halliburton BV Albanian Branch”, Amendim i licencës (përdorim i burimeve radioaktive kategori III, IV dhe V)
18. Spitali Hygeia, Tiranë (Mjekësi Bërthamore, Radioterapi, Transport)
19. Fushë- Krujë, Cement Factory(burim radioaktiv Cf 252)
20. Qendra Diagnostikuese Medicare, Tiranë (Mjekësi Bërthamore dhe Transport)
21. Kompania “Tea” sh.p.k, Tiranë (burim radioaktiv Am-241)
22. Kompania “Nasto –Inxhiniering”, Vlorë (graf industrial me rreze X dhe burim radioaktiv Ir-192)
23. Klinika Mjekësore Jon, Elbasan (panorameks dhe graf/skopi)
24. Klinika Orthodokse e Ungjillizimit, Tiranë (graf/skopi, CT-Skaner, mamografi, panorameks)
25. Klinika Mirdita Dental, Tiranë (graf dentare dhe panorameks)
26. Kabineti Radiologjik “Suta”, Elbasan (graf dhe panorameks)
27. Studio Real, Tiranë (panorameks)
28. Dental Turk A, Tiranë (panorameks dhe graf dentare)


29. Klinika Dentare - Bujar Methasani, Tiranë (grafi dentare për përdorim personal)
30. Klinika "Gelioni Dent", Gjirokastrë (grafi dentare dhe panorameks)
31. Klinika "Graf dentare"- Klajdi Myftiu, Kavajë (panorameks)
32. Klinikë Dentare, Tiranë (grafi dentare për përdorim personal)
33. Klinika Radiologjike Dentare, Lezhë (panorameks dhe graf intraorale)
34. Kompania "LE.Energy Star", Durrës (import-eksport dhe transport i burimeve të hapura dhe të mbyllura radioaktive)
35. Deld sh.p.k, Klinika Profiti, Durrës (grafi, mamografi, panorameks dhe graf dentare)
36. Qendra Spitalore "AKS", Berat (Graf, Panorameks dhe Mamografi)
37. Kompania "Birra Tirana" Sh.a, Tiranë (burim i mbyllur Am-241 dhe gjenerator me rreze X)
38. Spitali Universitar i Traumës, Tiranë (3 pajisje Graf, Graf portative, 2 pajisje CT-Skaner)
39. Qendra Spitalore Universitare " Nënë Tereza", Departamenti i Radioterapisë (Co-60, Ir-192 dhe Akselerator)
40. Spitali Kavajë, (Graf/Skopi, Graf)
41. Graf dentare "Anjeza Shabanllari", Tiranë, (Panoramex dhe graf dentare)
42. Klinika dentare "Koral", Tiranë (Graf dentare për përdorim personal)
43. Klinika radiologjike "Logli", Gjirokastrë, (CT-Skaner dhe graf/skopi)
44. Kompania "Nasto Inxhiniering", Vlorë, (Transport të burimeve të rrezatimit jonizues)
45. Graf dentare "Balla", Vorë, (Panoramex dhe graf dentare)
46. Klinika "Dixhital Kavaja", Kavajë, (Panoramex)
47. Klinika "Arjon", Tiranë, (Panorameks)
48. Laboratori "Neo Style", Tiranë, (Densitometri të kockave dhe analiza in Vitro RIA)
49. Klinika "Aida Dental", Tiranë, (Panorameks)
50. Klinika dentare "Gazioni", Kavajë, (Panorameks)
51. Royal Diagnostic Center, Tiranë, (Graf/Skopi, mamografi, CT-Skaner)
52. Graf dentare "Toska", Elbasan, (Panorameks dhe graf dentare)
53. Spitali Amerikan, Tirana I, Tirana II, Durrës dhe Fier, (Graf/Skopi, CT-Skaner. Koronarografi, C-Arm, Litotripter, Graf e lëvizshme, Mamografi si dhe përdorim të lëndëve të hapura radioaktive Mo-99/Tc-99m dhe I-131, të cilat do të përdoren për diagnostikimin dhe terapinë e pacientëve në mjekësinë bërthamore)
54. Spitali European, Tiranë, (Graf/Skopi, Mamografi, CT-Skaner, Koronarografi)
55. Klinika "Amavita", Tiranë, (Graf, Mamografi dhe CT-Skaner)
56. Doctors Hospitals, Tiranë, (Graf, mamografi, densitometri të kockave)
57. Subjekti "Gentian Ismailaj", (Panorameks dhe Graf dentare)
58. Studio Imazherie "Gega", (Radiografi, CT-Skaner, Mamografi dhe Panorameks)
59. Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi"(Graf/Skopi, CT-Skaner dhe Angiografi)
60. Pets & Partners, Sh.p.k, (Graf)
61. City Dental Clinic, (2 Graf Dentare Intraorale dhe Panorameks)
62. Spitali Amerikan III, Sh.a, (2 Graf, CT-Skaner, 2 Angiografi, C-Arm, Graf e lëvizshme dhe Mamografi. Si dhe përdorim të lëndëve të hapura radioaktive Mo-99/Tc-99m dhe Gamma Camera , të cilat do të përdoren për diagnostikimin dhe terapinë e pacientëve në mjekësinë bërthamore në Spitalin Amerikan III)
63. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, (për përdorim të burimeve të rrezatimit jonizues, transport të burimeve të rrezatimit jonizues, ruajtje të përkohshme të burimeve të rrezatimeve jonizuese, import- eksport të burimeve të rrezatimeve jonizuese dhe trajtim të mbetjeve radioaktive)
64. Klinika "Glob Diagnostic Center", (Graf dhe CT-Skaner)
65. Kabinet Stomatologjik ENV, (Panorameks/ Cefalometri dhe Graf dentare)
66. "Dodbiba DENTAL" , (Panorameks/ Cefalometri dhe Graf dentare)

Veprimtaritë me burime të rrezatimit jonizues të licencuara nga KMR-ja për këtë vit janë paraqitur në tabelën 1, si më poshtë:

Burimi i rrezatimit jonizues	Grafi dentare/ Panorame x/ grafi dentare për përdorim personal	Grafi industriale me rreze X dhe burim radioaktiv	Burim i mbyllur kategori III, IV dhe V	Import eksport/ Transport të materialeve radioaktive	Radioterapi dhe Brakiterapi	Grafi dhe grafi/skopi, mamografi/Ang/ C-Arm	CT-Skaner	Mjekësi bërthamore	Ruajtje të përkohëshme, import eksport, trajtim mbetjesh radioaktive
Nr.	45	5	5	3	2	57	17	3	1


Tabela 1

Më poshtë, në grafikun 1 paraqiten veprimtaritë me burime të rrezatimit jonizues të licencuara gjatë vitit 2016.



Grafiku 1

Licenca të miratuara nga KMR gjatë 2016,2015,2014 shprehur në përqindje



Grafik 2

Në grafikun 2 është paraqitur në përqindje numri i licencave të miratuara gjatë viteve, 2014, 2015 dhe 2016. Gjatë vitit 2016 vihet re një rritje e numrit të subjekteve që kanë aplikuar për t'u pajisur me licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues dhe numri i licencave të miratuara nga KMR-ja gjatë 2016 është trefishuar. Në veçanti, risi e këtij viti është licencimi i grafive dentare, proces i cili ka qënë ndër vite problematik, këtë vit vlen të përmendet se procesi i licencimit të këtyre pajisjeve është përmirësuar.

INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

**PAJISJA ME AKTMIRATIM I VEPRIMTARIVE ME BURIME TË
RREZATIMIT JOJONIZUES**

Në zbatim të ligjit Nr.10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, i ndryshuar, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet është autoriteti kombëtar rregullator, që mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet përcakton masat e nevojshme për të siguruar që në çdo rast, ekspozimet e çfarëdo instalimi ose pajisjeje që emetojnë rrezatim jojonizues, të jenë në përputhje me normat e miratuara dhe rregulloret përkatëse.

Gjatë vitit 2016 janë paraqitur për t’u pajisur me aktmiratim në total 811 Stacione Bazë (SB) të kompanive të transmentimit celular, Vodafon Albania, Telekom, Albtelekom dhe Plus Communication, nga të cilat 687 SB janë pajisur me aktmiratim nga KMR-ja, 38SB nuk janë pajisur me aktmiratimi nga KMR-ja, pasi dokumentacioni ka pasur mangësi dhe nuk ka qënë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa 86 SB janë në proces vlerësimi nga ana e inspektorëve të ZMR-së.


Në ZMR gjatë vitit 2016 është përditësuar dhe inventari në mënyrë elektronike i të gjitha Stacioneve Bazë të pajisura me aktmiratim nga KMR-ja.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i aplikimeve gjatë vitit 2016 për Stacionet Bazë të kompanive të transmetimit celular, Vodafone Albania, Telekom, Albtelekom dhe Plus Communication.

KOMPANITË CELULARE	Numri total i SB të dorëzuara në ZMR në 2016	SB të pajisur nga KMR me akt- miratimi 2016	SB në proces vlerësimi	SB që nuk kanë kaluar në KMR në 2016
VODAFONE ALBANIA	316 SB	269SB	35SB	12SB
TELECOM	198 SB	172SB	21 SB	5SB
ALBTELECOM	192 SB	165 SB	20SB	7SB
PLUS	105 SB	81SB	10SB	14SB
TOTAL SB	811 SB	687SB	86 SB	38SB


Tabela 2

Në grafikun 3, është paraqitur numri i akteve të miratimit të aprovuara nga KMR-ja, për secilën kompani të transmetimit celular gjatë 2016.



Grafiku 3

Në grafikun 4, është paraqitur në përqindje numri i akteve të miratimit aprovuar nga KMR-ja gjatë vitit 2016, krahasuar me numrin e aktmiratimeve të aprovuara gjatë vitit 2015 dhe 2014. Nga grafiku shihet se numri i akteve të miratimit për stacionet bazë të lëshuara nga KMR-ja për vitin 2016 është rritur dyfish në krahasim me vitet e kaluara, kjo ka ardhur si rezultat i shtimit të numrit të aplikimeve në muaj (80 aplikime) për të katër kompanitë e transmetimit celular.



Grafiku 4

Një nga problematikat kryesore në këtë pikë, vazhdon të mbetet mungesa e pajisjeve për matjen e rrezatimit jojonizues, gjë e cila ka ndikuar direkt në inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, proces i cili nuk ka nisur akoma nga ana e ZMR-së. Kjo çështje është ngritur disa herë në mbledhjet e KMR-së dhe kërkesat për blerjen e tyre nga ana jonë drejtuar ISHP-së kanë filluar që në vitin 2014 e në vazhdim. Gjithashtu, duke parë ndjeshmërinë e madhe të publikut ndaj këtyre rrezatimeve, blerja e tyre është ngritur si çështje dhe nga institucioni i Avokatit të Popullit.

1. INSPEKTIMI I SUBJEKTEVE QË USHTROJNË VEPRIMTARI ME BURIME TË RREZATIMIT JONIZUES

Në zbatim të ligjeve në fuqi, rregullores Nr.10 datë 7.1.2010, “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues”, si dhe në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2016, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, me Nr.1579/5prot, datë 22.10.2015, janë realizuar inspektimet e planifikuara vetëm për subjektet e licencuara për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues. Inspektimi gjatë 2016 ka përfshirë dhe një inspektim jashtë programit, pranë qendrës shëndetësore të specialiteteve në Paskuqan, autorizimi i të cilit është bërë me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, sipas Ligjit "Për inspektimin në R.SH", Nr.10433, datë 16.06.2011, neni 18 pika 5.

Në zbatim të urdhërit Nr.321, datë 30.07.2015, të Ministrit të Shëndetësisë, gjatë vitit 2016 janë hequr nga grafiku i inspektimeve të gjithë subjektet të cilët ushtrojnë veprimtari pa licencë dhe që në zbatim të udhërit të mësipërm janë objekt inspektimi dhe verifikimi i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

Të gjitha inspektimet janë bërë në përputhje dhe me Ligjin Nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe legjislacionin në fuqi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizues.

Inspektimi është realizuar nëpërmjet njoftimit paraprak të subjektit përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, si zyrtarisht ashtu dhe me telefon.

Gjithashtu janë plotësuar autorizimet për çdo inspektim ku janë përcaktuar elementët e mëposhtëm:

- a) Inspektorati shtetëror apo vendor përkatës, që lëshon autorizimin;
- b) Objekti i inspektimit;
- c) Baza ligjore;
- ç) Data dhe vendi i lëshimit;
- d) Identiteti i inspektorit apo i inspektorëve të autorizuar për të kryer inspektimin;
- dh) identiteti i personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e veprimeve ndihmëse,
- e) Emri apo emërtimi dhe adresa e subjektit të inspektimit, të dhëna për përcaktimin sa më të qartë të tij, në rastin e inspektimit rastësor, apo të dhëna për përcaktimin sa më të saktë të veprimtarisë konkrete që i nënshtrohet inspektimit, në rast se emri, emërtimi dhe adresa nuk janë të njohura;
- ë) Kohëzgjatja në ditë për kryerjen e inspektimit;
- f) Vendi apo vendet ku do të kryhet inspektimi;
- g) Të dhënat e identifikimit, pozicioni dhe nënshkrimi i personit që ka lëshuar autorizimin.

Pas përfundimit të inspektimit është plotësuar dokumentacioni përkatës, si Listat e Kontrollit dhe Procesverbalet, ku një kopje i është lënë subjektit, duke përcaktuar konkluzionet, rekomandimet, detyrat e lëna, si dhe afatet kohore për plotësimin e tyre.

Gjatë vitit 2016 janë realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X, si dhe në ato qendra ku aplikohet me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive. Për kryerjen e inspektimeve janë vënë në dispozicion nga laborantja e ZMR-së të gjitha pajisjet e nevojshme dhe janë realizuar matje në lidhje me fuqinë e dozës, në ambientet publike dhe në ato ambiente ku stafi është i angazhuar në punë me burime të rrezatimit jonizues. Në bazë të këtyre matjeve është përcaktuar doza efektive vjetore për publikun dhe stafin. Gjithashtu qëllimi i inspektimit në këto qendra ka qenë dhe kontrolli i parametrave teknik të tyre.

Inspektimet e realizuara gjatë vitit 2016:

Subjekte Shtetërore

- 1- QSUT Qendra e Radiologjisë, Tiranë.
- 2- QSUT Mjekësia Bërthamore, Tiranë.
- 3- QSUT Qendra e Radioterapisë, Tiranë.
- 4- Spitali i Neurologjisë- Akseleratori, Tiranë.
- 5- Spitali Universitar i Traumës, Tiranë
- 6- Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.
- 7- Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Tiranë.
- 8- Posta Shqiptare, Tiranë.
- 9- Shërbimi Spitalor, Kavajë.
- 10-Qendra Shëndetësore e Specialiteteve, Paskuqan.

Subjeket Private

- 1- Medicare, Tiranë.
- 2- Neo Style, Tiranë.
- 3- Coca – Cola, Tiranë.
- 4- Spitali Amerikan, Tiranë.
- 5- Kompania Stefani& Co, Tiranë.
- 6- Tea sh.p.k,Tiranë.
- 7- Birra Tirana, Tiranë.
- 8- Spitali Hygeia – Akseleratori Tiranë.
- 9- Klinika Ortodokse e Ungjillizimit, Tiranë.
- 10- Klinika Amavita, Tiranë.
- 11- Klinika dentare Arjon, Tiranë.
- 12- Klinika dentare Egian, Tiranë
- 13- Blu Medical Center, Tiranë.
- 14- Klinika Diplomat, Tiranë.
- 15- Zonja e Këshillit të Mirë, Tiranë.
- 16- Royal Diagnostic Center, Tiranë.
- 17- Glob Diagnostic Center, Tiranë.
- 18- Tirana International Airport, Tiranë.
- 19- Spitali European, Tiranë.
- 20- Klinika Komuna e Parisit, Tiranë.
- 21- Klinika 3 Yjet, Tiranë.


- 22- Limak – Age Joinventure (Banja Elbasan)
- 23- Klinika Golloshi, Tiranë.
- 24- Spitali Salus, Tiranë.
- 25- SFI Spille, Durrës.
- 26-Lulaj X- Ray, Vlorë.
- 27 -Klinika Gëzim Idrizi, Durrës.
- 28- Klinika dentare Arlind Lala, Durrës.
- 39- Grafi Toska, Elbasan.
- 30- Kabineti Radiologjik Suta, Elbasan.
- 31- Klinika Mjekësore Jon, Elbasan.
- 32- Klinika Çeçi Dent, Sarandë.
- 33- Klinika Radiology Center, Sarandë.
- 34- Klinika Brianza Dent, Fushë- Krujë.

Pas përfundimit të inspektimit është plotësuar dokumentacioni përkatës, si Listat e Kontrollit dhe Procesverbalet, ku një kopje i është lënë subjektit, duke përcaktuar konkluzionet, rekomandimet, detyrat e lëna, si dhe afatet kohore për plotësimin e tyre.




INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

Në grafikun 5, është paraqitur numri i inspektimeve të kryera në subjektet private dhe shtetërore gjatë vitit 2016. Nga grafiku vihet re që numri i inspektimeve në subjekte shtetërore është shumë herë më i vogël se ai në subjektet private, kjo ka ardhur si rezultat, pasi pothuajse një pjesë e mirë e qendrave spitalore shtetërore ushtrojnë veprimtari pa licencë ose ju ka mbaruar afati i licencës dhe janë hequr nga grafiku i inspektimit të parashikuara për vitin 2016.



Grafiku 5

Në grafikun 6, paraqitet numri i inspektimeve të kryera gjatë vitit 2016, karahasuar me vitet 2015 dhe 2014.




Grafiku 6

SANKSIONET

Në zbatim të udhëzimit Nr.676, datë 05.12.2008, “Për shkallën e penalizimit për shkeljet administrative” të parashikuara në ligjin Nr.8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizues”, i ndryshuar, gjatë vitit 2016 janë plotësuar 43 procesverbale dhe nuk është marrë asnjë vendim me gjobë, pasi në asnjë rast nuk është hasur gjatë inspektimit shkelje të dispozitave të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të ligjit. Në ndryshim nga vitet e tjera në zbatim dhe të rekomandimeve të nxjerra nga audit i Inspektoratit Qendror, gjatë këtij viti është plotësuar procesverbal për të gjitha subjektet e inspektuara. Sipas rekomandimeve proces verbali duhet të plotësohet në çdo rast dhe për secilin subjekt ku duhet të paraqitet situata e konstatuar gjatë inspektimit.

Në grafikun 7, paraqitet numri i procesverbaleve të plotësuara nga inspektorët e ZMR-së gjatë vitit 2016, karahasuar me vitet 2015 dhe 2014.



Grafiku 7

BASHKËPUNIMI ME INSPEKTORATIN QENDROR

Në zbatim të ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në muajin tetor 2016 u organizua auditimi nga Inspektorati Qendror (IQ) në lidhje me programin e mbikëqyrjes për veprimtarinë inspektuese të ZMR-së.

Në raportin e dërguar nga grupi i kontrollit janë pasqyruar konkluzionet e arritura nga vlerësimi, si dhe janë dhënë disa rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë inspektuese.

Në lidhje me raportin përfundimtar të dërguar, ZMR-ja ka shprehur observimet dhe kontestimet e saj për disa nga pikat i janë parqatur IQ-së.

Shkëmbime informacioni ka pasur vazhdimisht, duke informuar dhe IQ-në.

Programi vjetor është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programi vjetor i inspektimeve planifikon në mënyrë sasiore aktet e inspektimit dhe është bazuar në :

- 1-Numrin e inspektoreve dhe kualifikimet e tyre
- 2-Numrin e subjekteve dhe kategoritë e tyre
- 3-Shpërndarjen territoriale të subjekteve të inspektimit sipas objekteve të inspektimit

4-Kompleksitetin e subjekteve.

Nuk kryhen inspektime në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese.

Numri i inspektivave është në përputhje të plotë me logjistikën dhe stafin e ngarkuar për inspektimin.

Në bazë të analizës të bërë numri i subjekteve që inspektohen në një vit është afërsisht 35- 40 subjekte, ose afërsisht rreth 4 inspektime në muaj. Pjesën tjetër inspektorët janë angazhuar me përgatitjen e dokumentacionit në përputhje me ligjet e inspektivimit dhe përshtatjen e tyre. **Me shtimin e inspektivimit të veprimtarive me rrezatimet jojonizuese, është e domosdoshme shtimi i stafit të ZMR-së. Kjo çështje duhet të theksohet në raportin përfundimtar .**

ZMR –ja siç shihet dhe nga detyrat që i ngarkojnë ligjet mbulon jo vetëm inspektivimin e burimeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues, por të gjithë procesin e licencimit dhe pajisjes me aktmiratimi të burimeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues, që nga momenti i njoftimit nga ana e subjektit deri në vlerësimin e dosjes nëse plotësohen të gjitha kërkesat rregullatore dhe dërgimin më pas për miratim në KMR. ZMR-ja mbulon të gjithë procesin e import - eksportit dhe transportit të burimeve të rrezatimit jonizues, është përgjegjëse për përgatitjen e bazës ligjore, ligje rregullore, procedura, udhëzues etj, për përgatitjen e të cilëve në mungesë dhe të një juristi në zyrë, secili nga inspektorët është përgjegjës për përgatitjen apo rishikimin, përputhshmërinë me direktivat europiane të rregulloreve përkatëse; pra puna në ZMR nuk është vetëm inspektivimi në terren. Nëse do të dilte i gjithë stafi në terren nuk do të plotësohet pjesa tjetër e detyrave për të cilat ZMR-ja është përgjegjëse dhe ia ngarkon ligji. Dhe pse me numër të kufizuar të stafit, të mungesës së pajisjeve, si dhe problematikës së ndryshme që ndeshet rrugës, ZMR-ja ka arritur të realizojë planin sipas parashikimeve dhe të jetë efektive. Sigurisht që ka vend për përmirësim dhe ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë për të përmirësuar atë çka nuk shkon mirë dhe nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në zbatim të urdhërit të Ministrisë të Shëndetësisë Nr. 321, datë 30.07.2015, subjektet që ushtrojnë veprimtari pa licencë, janë objekt inspektivimi dhe verifikimi i ISHSH-së, ndërsa ZMR-ja verifikon nëpërmjet matjeve të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues me licencë, të cilën e kanë aktive.

Formatet standard të përgatitura janë në përputhje me ligjin për inspektivimin, të cilat janë dërguar për printim dhe do të zbatohen gjatë 2017.

ZMR-ja ka përfunduar dokumentacionin si më poshtë:

- a. Lista e kontrollit për radiologjinë
- b. Lista e kontrollit për burime të mbyllura
- c. Lista e kontrollit për burime të hapura
- d. Lista e kontrollit për transportin e materialeve radioaktive,

Lista e kontrollit për transportin të lëndëve radioaktive do t'u dërgohet për mendim shumë shpejt institucionit tuaj.

MIRATOHET Rustem PACI Kryetar i ZMR Date _____ / _____ / 2016 Plani i Veprimit për Rekomandimet e Mbikëqyrjes							
Nr. Rendor	Rekomandimet	Realizimi sipas afatit	Vendosja për monitorim	Përgjegjësi për veprimet	Statusi i veprimit	Data e parafundimit	Dokumentet e punës së rehatimit
1	Në dokumentacionin e mbajtur gjatë verimitarëve inspektues, të shprehur bazë ligjore dhe kur nuk ka konstatim të shkeljeve të kërkesave ligjore.	E mesme	I. Murat Inspektori	Inspektori përgjegjës	në proces	2017	Është marrë në konsideratë në formatet standard të përgatitura në përputhje me ligjin për inspektimin, të cilat janë dërguar për printim.
2	Procesi i inspektimit duhet të mbështetet në vendim nga nenet 46 dhe 47 të ligjit për inspektimin.	I lartë	I. Murat Inspektori	Inspektori përgjegjës	në proces	2017	Është marrë në konsideratë në formatet standard të përgatitura në përputhje me ligjin për inspektimin, të cilat janë dërguar për printim.
3	Formatet standard që përdoren gjatë verimitarëve inspektues duhet të plotësohen në të gjitha rubrikat e tyre dhe duhet të jenë sipas formatit të miratuar nga Inspektori Qendror, dhe bërë të mundur unifikimin e praktikave të inspektimit në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe duke i sjellë në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin.	E mesme	I. Murat Inspektori	Inspektori përgjegjës	në proces	2017	Është bërë përshtatja dhe unifikimi i tyre. Janë në printim nga ISHP Tirane.
4	ZMR duhet të fillojë sa më parë rishikimin e listë verifikimeve ekzistuese dhe hartimin e atyre të reja për sa i përket transportit të burimeve jonizuese si dhe hartimin e listë verifikimeve të reja në fushën e inspektimit të burimeve jonizuese.	I lartë	I. Murat Inspektori	Inspektori përgjegjës	përfunduar	Nëntor - Dhjetor 2016	Lista e kontrollit për radiologjinë Lista e kont. për burime të mbyllura Lista e kont. për burime të hapura Lista e kontrollit për transportin e materialeve radioaktive.

BASHKËPUNIMI ME INSPEKTORATIN SHËNDETËSOR

Në zbatim të Ligjit Nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, i ndryshuar, Ligjit Nr.10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues”, i ndryshuar dhe urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë Nr.321, datë 30.07.2015, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka vijuar bashkëpunimin me ISHSH-në, institucion i cili do të mbulojë verifikimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues dhe jojonizues nëse kanë licencë/aktmiratimi ose jo. Për aspektet teknike që lidhen me këtë proces, përgjegjëse për inspektimin do të jetë ZMR-ja. ZMR-ja ka informuar ISHSH-në në lidhje me subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues pa licencë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi gjatë 2017 do të nënshkruhet dhe marrëveshja e bashkëpunimit me këtë institucion.

OBJEKTIVAT PËR VITIN PASARDHËS NË LIDHJE ME INSPEKTIMIN

Në zbatim të urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë, Nr.321, datë 30.07.2015, për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror, në planin vjetor të inspektimeve të vitit 2017 janë planifikuar të gjithë inspektimet e subjekteve të licencuar. Subjektet që ushtrojnë veprimtari pa licencë, do të jenë objekt inspektimi dhe verifikimi i ISHSH-së.

Në rast konstatimi të mungesës së dokumentacionit gjatë inspektimit, ZMR-ja do të vërë në dijeni ISHSH-në, në lidhje me shkeljet. Fusha jonë e inspektimit është reduktuar vetëm në vlerësimin e parametrave teknike të instalimeve dhe vlerësimin e dozave me qëllim mbrojtjen e publikut dhe mjedisit.

Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese” Nr.8025, datë 09/11/1995, i ndryshuar, Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloreve përkatëse, si Kryetar i KMR-së dhe Ministër i Shëndetësisë, ka miratuar grafikun vjetor të inspektimeve për vitin 2017, si dhe ka autorizuar ZMR-në për realizimin e tyre.

Planifikimi i inspektimeve është bërë mbi bazën e riskut, frekuencës kohore dhe performancës së subjekteve, të klasifikuara me urdhër të brendshëm të ZMR-së, Nr. 18, datë 14. 07. 2015, dalë në

zbatim të Urdhërit të IQ-së, Nr.6, datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”.

Nr	QARKU	SUBJEKTI QË DO TË INSPEKTOHET	PERIUDHA KUR DO TË KRYHET INSPEKTIMI
1	Tirana	QSUT “Nënë Tereza”-Shërbimi Onkologjik (burimi i Co-60 dhe Akseleratori)	Janar, java e III-të
		QSUT “Nënë Tereza”-Shërbimi i Neurologjisë, (Akseleratori)	Janar, java e IV-të
		-Spitali Hygeia (Akseleratorët)	Shkurt, java e II-të
		-IFBZ (burimet radioaktive të kategorisë së I dhe II, dhe transportin e materialeve radioaktive)	Shkurt, java e III-të
		-Grafi dentare Nr. 1(panoramex) -Studio radiologjike “Nënë Tereza” (grafi dentare, panoramex) -Klinika Simon digital(grafi dentare, panoramex)	Mars, Java e II-të
		-Grafi dentare German (grafi dentare, panoramex) -Kompania Apave Albania (grafi industriale, burim radioaktiv Ir-192)	Mars, java e III-të
		-NDT Albania(2 aparate grafi industriale me rreze X) -Gener 2 Shpk (burim radioaktiv Ni-63)	Prill, java e I-rë
		-Klinika dentare “Oasis” (grafi dentare) -Klinika dentare Eva Dent (grafi dentare) -Klinika dentare turke “Billi Capman” (grafi dentare) -Klinika dentare Lumturi Brahimllari (grafi dentare)	Prill, java e II-të dhe e III-të
		-Klinika dentare “Irma” (grafi dentare) -Klinika dentare “Buzëqeshja” (grafi dentare) -Klinika dentare Ersida Çalja (grafi dentare) -Klinika “Advantage Dental” shpk (panoramex)	Maj, java e II-të dhe III-të
		-Spitali i kafshëve të vogla “Petlife” (grafi) -Radiografi dentare, Panoramex Vera Nikolli	Qershor java e I-rë

		-Klinika dentare Toti & Gurakuqi (panoramex) -Spitali Kontinental (grafi, CT-Skaner, mamografi, litotript) - Grafi dentare “Galeria” (grafi dentare, panoramex)	Qershor, java e III-të
2	Fier, Lushnje	-Spital Rajonal Fier (grafi, CT –Skaner, mamografi) -Spitali Lushnje (skopi, grafi) - Western Atlas International, Fier (burime radioaktive për qëllime industriale, Ra-226, 2 burime Am-241/Be,Cs-137) -Weatherford Services, Fier (burime radioaktive për qëllime industriale, Am-241 Be, Cs-137)	Korrik, java e I-rë dhe e II-të
3	Përmet,	-Spitali Rajonal Përmet (grafi/skopi, grafi dentare)	Shtator, java e III-të
4	Has, Kukës,	-Spitali Krumë (grafi/skopi) -Shoqëria “Beni Shpk” (grafi dentare, panoramex) Kukës -Kompania “Eurochrome” shpk (burim radioaktiv Cs-137) Kukës	Tetor, java e II-të
5	Berat;	-Spital Rajonal Berat(grafi, skopi, CT-Skaner) -Poliklinikë Berat (mamografi, grafi/skopi) -Qendra spitalore “Aks”(grafi, panoramex, mamografi)	Nëntor, java e I-rë
6	Durrës;	-Klinika Enesi (grafi/skopi) -Klinika radiologjike Profiti(grafi, panoramex, mamografi, grafi dentare) -Klinika Medicare (CT-skaner, grafi/skopi) -Kompania “Remu Ballkan” shpk (grafi industriale me rreze X)	Dhjetor java e I-rë dhe e II-të

Numri i inspektimeve të planifikuara në total për vitin 2017 do të jetë 40 subjekte, nga të cilat;

*5 subjekte në bazë të vlerësimit të riskut inspektohen çdo vit

*17 subjekte në bazë të vlerësimit të riskut inspektohen një herë në 5 vjet

*18 subjekte në bazë të vlerësimit të riskut inspektohen një herë në 2 vjet

Në bazë të Ligjit Nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në RSH”, ky grafik nuk përfshin inspektimet jashtë planit të inspektimit për subjektet që janë në proces licencimi, Neni 25 pika 1/a, situatat emergjente, aksidenteve etj, Neni 25 pika1/ç e këtij ligji, si dhe rastet siç parashikohen në pikën 5 të nenit 18 dhe në pikën 5 të nenit 19, të këtij ligji;

Çdo inspektim do të kryhet nga të paktën dy inspektorë dhe laboranti i ZMR-së, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Kryetari i Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Për çdo inspektim subjekti do të njoftohet paraprakisht jo më vonë se 3 ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, kjo në përputhje me ligjin për inspektimin, kohën e inspektimit dhe grupin e inspektimit, sipas grafikut të mësipërm.

ANEKSI 2, format i cili është plotësuar në përputhje me kërkesat e urdhërit të Inspektoratit Qendror, Nr.7 datë 19.02.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë të veprimtarisë së inspektimit dhe kriteret e vlerësimit së raportimit të tyre”.



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

Nr.	Treguesit e vlerësimit të veprimtarisë inspektuese	Përqindja (%) e peshës specifike për çdo tregues	Kritere të vlerësimit të treguesit	Vlerësimi 1	Vlerësimi 2	Vlerësimi 3	Vlerësimi 4
1	Inspektime të programuara	43	numri i inspektimeve të kryera brenda programit (numri i inspektimeve të kryera jashtë programit)/numri i inspektimeve të kryera gjithsej				80-100%
2	Inspektime të autorizuar	43	numri i autorizimeve me programim (numri i autorizimeve jashtë programit)/numri i autorizimeve të gjeneruara				80-100%

3	Njoftimi i inspektimeve	43	numri i inspektimeve të njoftuara (numri i inspektimeve të panjoftuara)/numri i inspektimeve të kryera gjithsej				80-100%
4	Kohëzgjatja e inspektimit	0	numri i inspektimeve për të cilat është kërkuar shtyrje e kohëzgjatjes së tyre apo atyre që kalojnë kohën maksimale të inspektimit në subjekt/ numri i përgjithshëm të inspektimeve				80-100%
5	Rezultati nga marrje mostre	N/A	numri i shkeljeve të kërkesave ligjore të konstatuara nga analiza e mostrave/numri i mostrave të marra	N/A			
6	Masat urgjente të marra	0	numri i masave urgjente/numri i procesverbaleve të inspektimit	≤ 20%			
7	Revokimet nga ankimet administrative	0	numri i vendimeve të revokuara/ numri i ankimeve administrative gjithsej	≤ 20%			
8	Revokime nga vendime të gjykatës	0	numri i vendimeve të rëzuara/numri i ankimeve gjyqësore gjithsej	≤ 20%			
9	Dënime administrative të vendosura		numri i dënime administrative të vendosura (ndjekje penale)/ numri i procesverbaleve të inspektimit	≤ 20%			
10	Shkelje e procedurës së inspektimit	0	numri i revokimeve për shkak të shkeljes së procedurës së inspektimit/numri i ankimeve gjithsej				≤ 20%
11	Respektimi i vendit të inspektimit	1	numri i inspektimeve të kryera jo në vendin e përcaktuar në autorizim/ numri i inspektimeve gjithsej				≤ 20%
12	Dënime administrative të ekzekutuara	0	numri i dënimeve administrative kryesore apo plotësuese të ekzekutuara/ numri i dënimeve administrative gjithsej	≤ 20%			
13	Numri i inspektimeve të kryera	43	numri i inspektimeve të kryera/ numri i inspektimeve të planifikuara				80-100%
14	Dënime administrative gjopa në vlerë	0	shuma absolute e gjobave/ të ardhura gjithsej	≤ 20%			

	absolute						
15	Rregullsia e dokumentimit të procesit të inspektimit	0	numri i inspektimeve me shkelje të ndëshkuara me ecuri disiplinore për inspektorët/ numri i inspektimeve gjithsej				≤ 20%
16	Etika dhe sjellja e inspektorëve shtetërorë	0	numri i inspektorëve me shkelje të etikës/numri i inspektorëve gjithsej				≤ 20%
	Treguesit specifikë e vlerësimit të veprimitarisë inspektorese						
1	Treguesi i objektivit strategjik apo vjetor I		Kriteri i matshëm i vlerësimit				
2	Treguesi i objektivit strategjik apo vjetor II		Kriteri i matshëm i vlerësimit				

IMPORT-EKSPORTI I BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES

Procesi i import-eksporteve të materialeve radioaktive ka funksionuar mbështetur në VKM-në për import-eksportet në Republikën e Shqipërisë, Nr.158, datë 13.02.2008, si dhe udhëzuesin mbi import-eksportin, transitin e burimeve radioaktive të kategorive I dhe II në Republikën e Shqipërisë Nr.134, datë 12.04.2011.

Gjatë vitit 2016 janë dhënë 105 aprovime importi. Gjatë këtij viti janë kryer importe të burimeve radioaktive të mbyllura, të përfshira në grupin e sigurimit C dhe D, si dhe burime të hapura radioaktive, të cilat përdoren në mjekësinë bërthamore për diagnostikimin dhe terapinë e pacientëve. Gjithashtu gjatë 2016 janë importuar dhe 4 grafi industriale me reze X, të cilat do të përdoren për kontrollin e saldimeve.

Numrin më të madh të importeve e zënë burimet e hapura, të cilat përdoren nga qendrat spitalore private dhe shtetërore për qëllime diagnostikuese dhe terapeutike të sëmundjeve të ndryshme.

Për sa i takon eksporteve, gjatë 2016 janë lëshuar 3 aprovime eksporti, janë eksportuar 4 burime radioaktive Cs-137. Këto burime janë përdorur nga kompania “Nasto inxhiniering” dhe “Weatherford”, për grafi industriale dhe qëllime karotazhi në industrinë e naftës. Eksporti është kryer sipas kontratave të nënshkruara për kthimin e burimeve radioaktive tek prodhuesi në fund të jetës së tij. Gjithashtu kompania “Shclumberger” ka bërë kërkesë për esporti e burimeve radioaktive CS-137 dhe Th-232, por ky aprovim nuk është realizuar për arsye

teknike të kompanisë dhe është kërkuar shtyrja e përdorimit të tyre deri në përfundim të afatit të licencës.

Kthimi i burimit tek prodhuesi ose furnizuesi në fund të përdorimit, ka qenë dhe mbetet një nga strategjitë e punës tonë, në mënyrë që të krijohen sa më pak mbetje në vend.

Më poshtë është paraqitur një shpërndarje e importeve dhe eksporteve të kryera gjatë vitit 2016 në mënyrë tabelore dhe grafike.


QSUT	Medicare	Neo Style	Hygeia	Sp Amerikan	Weatherford	Eurochrom	Nastoinxhiniering	Altea&Geostudio	IFBZ	Schlumberger
22	17	10	21	28	1	1	1	1	1	1
Mo-99/Tc-99 dhe I-131	Mo-99/Tc-99 dhe I-131	I-125	Mo-99/Tc-99 dhe I-131, F-18	Mo-99/Tc-99 dhe I-131	Cs-137	Cs-137	Cs-137 dhe gr/industriale	Am-241/Be	Burim standard	Cs-137 dhe Th-232

Tabela 3

Në grafikun 8, është paraqitur një shpërndarje e aprovimeve të import-eksportit të burimeve të rrezatimit jonizues, sipas subjekteve të licencuara, të dhëna gjatë vitit 2016.



Grafik 8



9

Në grafikun 9, është paraqitur në përqindje numri i import-eksporteve të miratuara gjatë vitit 2016, krahasuar me import-eksportet e kryera vitin 2015 dhe 2014, dhe e shprehur në përqindje.

TRANSPORTI I BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES

Transporti në Republikën e Shqipërisë kryhet nga subjekte të licencuara nga KMR-ja dhe që zbatojnë të gjitha dispozitat e rregullores “Për transportin e sigurtë të materialeve radioaktive” Nr.815, datë 16.11.2016, si dhe të gjitha dispozitat e tjera që lidhen me transportin. Kompani të licencuara për kryerjen e transportin janë: Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Qendra Diagnostikuese Medicare dhe Hygeia Hospital, të cilët kryejnë transport vetëm për interesa të kompanisë së tyre dhe jo për të tretët. Gjatë 2016 janë pajisur me licencë dhe dy kompani të tjera, Nasto inxhiniering, e cila ka kapacitete për kryerjen e transportit të burimeve radioaktive vetëm për interesa të kompanisë së tyre, si dhe kompania LE Energy Star, për kryerjen e import - eksporteve dhe transportin e materialeve radioaktive për të tretët.

Gjatë 2016, ZMR-ja ka dhënë në total 112 aprovime transporti për burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive, ku 105 janë aprovime transporti për burime të hapura si, Mo/Tc-99m,

I-131, I-125, F-18, të cilat përdoren në mjekësinë bërthamore për diagnostikimin dhe terapinë e pacientëve, ndërsa 7 prej tyre janë aprovime transporti për burime të mbyllura radioaktive si, Cs-137, Am-241-Be etj , të cilat përfshihen në grupin e sigurimit B, C dhe D, dhe janë përdorur gjatë këtij viti nga subjekte të licencuara, në fushën e industrisë së naftës, për matjen e densitetit të lagështisë, si dhe për kalibrim.

Më poshtë po paraqesim një shpërndarje në mënyrë tabelore dhe grafike të aprovimeve të dhëna për këtë vit.


Nr.i aprovimeve për transportin e burimeve radioaktive	
Medicare, IFBZ, Hygeia Hospital Burime të hapura	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar Burime të mbyllura
105	7

Tabela 4

Subjektet	Nr i aprovimeve të transportit të aprovuara për cdo subjekt gjatë 2016
IFBZ	66
Medicare	25
Hygeia Hospital	21


Tabela 5

Në grafikun 10, është paraqitur numri i aprovimeve të transportit lëshuar nga ZMR-ja për çdo subjekt të licencuar për kryerjen e kësaj veprimtarie.



Grafik 10

Në grafikun 11, është paraqitur në përqindje numri i aprovimeve për transport të dhëna për vitin 2016, të krahasuara me vitin 2015 dhe 2014



Grafik 11

MBLEDHJET E KOMISIONIT TË MBROJTJES NGA RREZATIMET

Gjatë këtij viti janë realizuar 4 mbledhje të KMR-së, ku janë shqyrtuar çështje dhe problematika të ndryshme, si dhe janë marrë disa vendime.

Mbledhja e datës 23 mars 2016

Çështjet kryesore të diskutuara si dhe vendime të marra në këtë mbledhje:

Çështja kryesore e diskutimit në këtë mbledhje, por dhe si një nga detyrat kryesore dhe më të rëndësishme të këtij viti, ishte realizimi i misionit IPPAS në Shqipëri, mision i cili ka si qëllim vlerësimin në lidhje me sigurimin fizik të burimeve radioaktive. Ky mision është krijuar nga ANEA me qëllim që të asistojë shtetet e ndryshme në forcimin e sistemit kombëtar, që lidhet me sigurimin e materialeve radioaktive, si dhe integrimin e institucioneve në këtë proces.

IPPAS-i, nëpërmjet ekspertëve në këtë fushë do të vlerësojnë gjithçka ka të bëjë me sigurimin fizik të burimeve radioaktive në Shqipëri, duke e krahasuar atë me praktikën më të mira ndërkombëtare, si dhe do të bëjnë rekomandimet e tyre për përmirësime.

Në këtë kuadër, për realizimin me sukses të këtij misioni u pa e nevojshme nxjerrja e një urdhëri nga Ministri i Shëndetësisë. Ministria e Punëve të Jashtme sugjeroi që MSH-ja dhe ISHP-ja të siguronin fondet e nevojshme për këtë mision, të sigurohej transporti i ekspertëve të huaj dhe shqiptarë si dhe të sigurohej logjistika e nevojshme për një punë normale.

Kryetari i KMR-së urdhëroi Drejtorinë Juridike pranë Ministrisë së Shëndetësisë për formulimin e këtij urdhëri dhe firmosjen e tij nga Ministri, si kryetar. Urdhërit duhet t'i bashkëngjitet dhe një relacion në lidhje me shpenzimet.

Në këtë mbledhje, KMR-ja pasi shqyrtoi aplikimet për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues, pajisi me Aktmiratimi 206 Stacione Bazë, të cilat i përkasin kompanive të transmetimit celular “Vodafone Albania”, “Albtelekom”, “Telekom” dhe “Plus Communication” dhe ishin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Një çështje për të cilën është diskutuar në këtë mbledhje ishte dhe nisja e procesit të pajisjes me Aktmiratimi të antenave të transmetimit televiziv, apo ato të transmetimit të tensionit të lartë për të cilën Z.Paci sqaroi se, Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet nuk ka kapacitete njerëzore për nisjen e këtij procesi, duke qënë se stafi i angazhuar në këtë proces në ZMR është i vogël; vetëm 3 inspektorë, të cilët bëjnë vlerësimin e Stacioneve Bazë të transmetimit të telefonisë celulare bazuar në ekspertizën e paraqitur nga operatorët nëpërmjet ekspertëve përkatës.

Numri i stacioneve bazë që paraqiten pranë ZMR-së për t’u pajisur me Aktmiratimi është 80 aplikime në muaj, për të katërt operatorët në total.

Në këto kushte është e pamundur që ky proces të vazhdojë dhe për veprimtaritë e tjera me burime të rrezatimit jojonizues, duke pasur parasysh se zhvillimi i teknologjisë dhe futja e transmetimeve 4G në sistem, do të sjellë rivlerësim të të gjithë SB-ve nga e para.

Kryetari i KMR-së rekomandoi që nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së, t’i dërgohet një shkresë në rrugë zyrtare Ministrisë së Financave, ku t’i kërkohet rritja në numër e stafit të ZMR-së, në mënyrë që ky proces të ketë vazhdimësi dhe të realizohet vlerësimi i të gjithë operatorëve të transmetimeve elektromagnetike në Shqipëri, pasi kjo gjë do të sillte rritjen e të ardhurave për shtetin si dhe rritjen e cilësisë së punës së KMR-së.

KMR-ja në këtë mbledhje ka miratuar licencat për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, si më poshtë:

1. Qendra Spitalore Universitare “ Nënë Tereza”, Mjekësia Bërthamore, Tiranë.
2. Spitali Rajonal dhe Poliklinika Berat (Graf/skopi, Mamografi, CT-Skaner).
3. Spitali “ Ismet Shushi”, Delvinë (Graf).
4. Spitali Rajonal Fier (Graf, CT-Skaner, Mamografi).
5. Spitali Rajonal dhe Poliklinika Vlorë (Graf, Skopi, CT-Skaner).
6. Spitali Përmet (Graf/ Skopi, Graf Dentare).
7. Spitali Krumë, Has (Graf/Skopi).
8. Spitali Pukë (Graf).
9. Spitali Sarandë (CT-Skaner, Graf, Skopi).
10. Spitali Kontinental, Tiranë (Graf, CT-Skaner, Mamografi, Litotript).
11. Remu Balkans, Durrës (Radiografi Industriale me rreze X).
12. Kompania “Eurochrome”, Kukës (Burim i mbyllur Cs-137).
13. Klinika Tona Dent, Korçë (Graf dentare dhe Panorameks).
14. Klinika Dentare Toti & Gurakuqi, Tiranë (Panorameks Cefalometri).
15. Grafia Dentare “ Galeria”,Tiranë (Panorameks Cefalometri dhe Graf Dentare).
16. Klinika e Imazherisë “ Golloshi”, Tiranë (Panorameks, graf dentare, Graf).
17. Kompania Halliburton BV Albanian Branch

KMR-ja mori vendim që të gjitha aplikimet për rinovimin e licencës do të rishqyrtohen nga ana e KMR-së dhe më pas të pajisen me licencë. Subjektet të cilat do të rishqyrtohen janë si më poshtë:

1. Spitali Hygeia, Tiranë
2. Fushë- Krujë, Cement Factory
3. Qendra Diagnostikuese Medicare, Tiranë
4. Kompania Tea sh.p.k, Tiranë
5. Kompania Nasto –Inxhiniering, Vlorë
6. Klinika Mjekësore Jon, Elbasan
7. Klinika Orthodokse e Ungjillizimit, Tiranë
8. Klinika Mirdita Dental, Tiranë
9. Kabineti Radiologjik “Suta”, Elbasan

10. Studio Real, Tiranë
11. Dental Turk A, Tiranë

Në lidhje me kërkesat për njohje nga ana e KMR-së, të IFBZ-së dhe Edna Farma-s, të cilët kanë plotësuar dosjet, në përputhje me Udhëzuesin Nr.1526/1 datë 13.04.2012, “ Mbi elementët për njohje nga ana e KMR-së për personat juridikë e fizikë që kryejnë matje me rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, kalibrim të pajisjeve radiometrike dhe matëse të rrezatimeve, trajnime dhe shërbimin e dozimetrisë personale”. Nga vlerësimi i dosjeve në ZMR, rezulton se të dy subjektet kanë kapacitete teknike dhe njerëzore për realizimin e matjeve me rrezatime jonizuese, kontrollin e cilësisë së instalimeve radiologjike në mjekësi.

KMR-ja mori vendim që, IFBZ-ja të pajiset me çertifikatë njohjeje nga ana e KMR-së për ushtrimin e kësaj veprimtarie, ndërsa për kompaninë “Edna Farma”, KMR-ja vendosi që të pajiset me çertifikatë njohjeje pas verifikimit të Çertifikatës së Regjistrimit në QKR.

Përfaqësuesja e IFBZ-së nuk mori pjesë në votimin për njohjen e IFBZ-së, kjo për shkak të konfliktit të interesit.

Në këtë mbledhje anëtarët e KMR-së u bënë me dije se në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror”, Nr.321, datë 30.07.2015, fusha e inspektimit për ZMR- në, reduktohet vetëm në subjektet që kanë licencë, si dhe në vlerësimin e parametrave teknikë të instalimeve, vlerësimin e dozave me qëllim mbrojtjen e publikut, punonjësve dhe mjedisit në tërësi. Inspektimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues dhe jojonizues pa licencë, do të kryhet nga ISHSH-ja.

Në çdo rast të konstatimit nga ana e ZMR-së të mungesës së dokumentacionit, do të vërë në dijeni ISHSH-në, në lidhje me shkeljet. Gjithashtu, të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari pa licencë janë hequr nga grafiku i inpektimeve për vitin 2016 dhe ky informacion i është dërguar në rrugë zyrtare të dy institucioneve, ISHSH-së dhe IQ-së.

Gjithashtu në zbatim të Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, si inspektorat shtetëror ka përshtatur rregulloren e brendshme me disa ndryshime specifike të punës së zyrës, e cila do të ndihmojë në funksionimin e brendshëm të ZMR-së dhe do të miratohet nga Kryetari i ZMR-së.

Në zbatim të matricës të parashikuar për vitin 2016, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka përgatitur draftregulloren për trajtimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, e cila ishte parashikuar për miratim në tremujorin e dytë të 2016.

Rregullorja i është dërguar për komente dhe përfaqësuesve të Institutit të Fizikës Bërthamore, si një nga institucionet kryesore - pjesë e këtij procesi, të cilët janë shprehur parimisht dakord me draftin e saj.

KMR-ja miratoi në parim draftregulloren, e cila është dërguar për mendim në ministrinë e linjës dhe është miratuar tashmë me vendim në KM.

Në pikë e diskutimit ka qënë dhe sistemi i funksionimit të ZMR-së, ku lidhur me këtë pikë u diskutua përdorimi i vulës nga ana e ZMR-së, gjë e cila deri në këto momente është bërë mbi bazën e një urdhëri të Ministrit të Shëndetësisë në kohën e krijimit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet në vitin 1996.

Ky urdhër ministri nuk gjendet në arkivën e MSH dhe kalimi i vulës është bërë nga Kryetari paraardhës i ZMR-së. Duke qënë se ZMR-ja nuk është person juridik, përdorimi i vulës në këtë rast, sipas mendimit dhe referencës ligjore të Znj. Njehrrëna, Drejtore Juridike në MSH, njëkohësisht dhe anëtare e KMR-së, bëhet me një urdhër Ministri, ku të jepen dhe specifikat përkatëse, duke marrë në konsideratë ligjet për mbrojtjen nga rrezatimet, si dhe VKM-në përkatëse për pagat në ISHP.

Mbledhja e datës 18.05.2016

Çështjet kryesore të diskutuara si dhe vendime të marra në këtë mbledhje:

Bazuar në matricën ligjore të parashikuar për vitin 2016, KMR-ja miratoi në parim në këtë mbledhje rregulloren “Për transportin e sigurtë të materialeve radioaktive”, e cila është rishikuar në përputhje me Ligjin për ADR-në, Ligjin Nr.118/2012, “Për transportin e sigurtë të materialeve të rrezikshme” dhe është parashikuar për miratim nga Këshilli i Ministrave në tremujorin e III të 2016.

Rregullorja e transportit ka marrë në konsideratë elementë si: inspektimi i transportit të materialeve radioaktive, sigurimi fizik i materialeve radioaktive gjatë transportit, miratimin e një programi trajnimi, i cili do të përfshijë trajnimin e personelit të angazhuar në transportin e këtyre materialeve, si dhe elementë të tjerë që lidhen me transportin e sigurtë të materialeve radioaktive.

KMR-ja në këtë mbledhje, pasi shqyrtoi aplikimet për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues, pajisi me Aktmiratimi 182 Stacione Bazë, të cilat i përkasin kompanive të transmetimit celular “Vodafone Albania”, “Albtelekom”, “Telekom Albania” dhe “Plus Communication”, të cilat ishin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Një çështje e diskutuar në këtë mbledhje ishte dhe problematika që është ndeshur me SB Teuta 2, i cili ndodhet në rrugën “Pavarësia”, 800m nga ura e Dajlanit, Durrës. Lidhur me këtë SB është dërguar vlerësimi i përbashkët, i cili ka marrë në konsideratë të tre operatorët, Vodafone Albania, Plus Communication si dhe Albtelekom. Ekspertët në vlerësimin e tyre theksojnë se përmasat e zonës kritike janë të tilla që nuk prekin zonat publike dhe janë në përputhje me VKM-në Nr.743, datë 16.10.2012, “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”. Ekspertët shprehen se në çdo pikë të marrë në konsideratë, llogaritjet tregojnë që densiteti i fuqisë për të gjitha bandat e të tre operatorëve është $\Sigma(S_i/S_{max}) < 1$.

Bazuar në ekspertizën e paraqitur, e cila është firmosur nga të tre ekspertët dhe përfaqëuesit e kompanive, inspektori i ZMR-së shprehet në vlerësimin e tij se veprimtaria e këtyre stacioneve me burime të rrezatimit jojonizues është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kompanitë kanë aplikuar në ZMR për pajisjen me Aktmiratimi të këtyre SB-ve në datë 29.01.2016, dhe shkak i shtyrjes ka qënë për arsye se në zyrë kanë ardhur ankesa nga një prej banoreve të këtij pallati, e cila pretendon se antenat janë vendosur në tarracën e saj pa i marrë leje. Konflikti ka të bëjë me pronësinë në lidhje me tarracën ku janë vendosur antenat e transmetimit celular. ZMR-ja nuk është institucioni përgjegjës për zgjidhjen e konflikteve mbi pronësinë, por për vlerësimin teknik dhe përcaktimin e zonës kritike, jashtë së cilës vlerat e densitetit të fuqisë së fushës janë më të vogla se Nivelet e Referencës të paraqitura në Tabelën 2, Shtojca III, të VKM-së Nr.743, datë 16.10.2012, “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”.

KMR-ja ka marrë vendim që ky stacion bazë të pajiset me Aktmiratimi. Në lidhje me konfliktin për pronësinë i takon institucioneve të tjera përgjegjëse për të marrë vendim.

KMR-ja mori vendim dhe miratoi në këtë mbledhje licencat për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues si më poshtë:

1. Klinika Dentare - Bujar Methasani, Tiranë (grafi dentare për përdorim personal).
2. Klinika “Gelioni Dent”, Gjirokastrë (grafi dentare dhe panorameks).
3. Klinika “Graf dentare”- Klajdi Myftiu, Kavajë (panorameks).
4. Klinikë Dentare, Tiranë (grafi dentare për përdorim personal).
5. Klinika Radiologjike Dentare, Lezhë (panorameks dhe grafi intraorale).
6. Kompania “LE.Energy Star”, Durrës (import-eksport dhe transport i burimeve të hapura dhe të mbyllura radioaktive).
7. Deld sh.p.k, Klinika Profiti, Durrës (grafi, mamografi, panorameks dhe grafi dentare).
8. Qendra Spitalore “AKS”, Berat (Graf, Panorameks dhe Mamografi).
9. Kompania “Birra Tirana” Sh.a, Tiranë (burim i mbyllur Am-241 dhe gjenerator me rreze X).
10. Spitali Universitar i Traumës, Tiranë (3 pajisje Grafi, Grafi portative, 2 pajisje CT-Skaner).
11. Qendra Spitalore Universitare “ Nënë Tereza”, Departamenti i Radioterapisë (Co-60, Ir-192 dhe Akselerator).

KMR-ja ka shqyrtuar në këtë mbledhje kërkesën e kompanisë “ICTS” për t’u njohur nga ana e KMR-së për kryerjen e trajnimit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese, vetëm për stafin e

Aeroportit “Nënë Tereza”, Tiranë. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në ZMR, kompania disponon kapacitete teknike dhe njerëzore për realizimin e këtyre trajnimeve dhe ka plotësuar kriteret sipas Udhëzuesit Nr 1526/1, datë 13.04.2012, “Mbi elementët për njohje nga ana e KMR-së për personat juridikë e fizikë që kryejnë matje me rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, kalibrim të pajisjeve radiometrike dhe matëse të rrezatimeve, trajnime dhe shërbimin e dozimetrisë personale”.

Një çështje tjetër e diskutimit në mbledhje, ishte dhe mbi problematikën e dalë nga rishqyrtimi i dosjeve nga mbledhja e kaluar, ku pjesa më e madhe ishin debitorë dhe nuk kishin shlyer detyrimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Në këto kushte KMR-ja mori vendim që në procesin e aplikimit për licencë, të shtohet si kriter për ato subjekte, të cilët janë në proces rinovimi të licencës, të paraqesin një vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ku të tregohet që, subjekti nuk ka detyrime tatimore të pashlyera pranë kësaj drejtorie. Kjo kërkesë do bazohet në kuadër të luftës kundër informalitetit.

Një çështje tjetër e diskutimit në këtë mbledhje ishte dhe draftudhëzuesi për metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit, i cili bazohet në ligjin Nr.8025 datë 9.11.1995, i ndryshuar si dhe ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë. Metodologjia e përcaktimit të dënimeve administrative në rastet kur subjektet kanë kryer shkelje të kërkesave ligjore do të bëhet mbi bazë pikësh.

KMR-ja mori vendim që udhëzimi të diskutohet në mbledhjen e ardhshme, pasi të merren në konsideratë disa modele nga vende të ngjashme me Shqipërinë.

Anëtarët e KMR-së u bënë me dije se në datat 29 gusht -2 shtator 2016, do të organizohet në Shqipëri një takim rajonal me temë: “Mbi dekomisionimin e instalimeve radioaktive”.

Takimi do të organizohet në bashkëpunim me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike - Vjenë, me Qeverinë Shqiptare, nëpërmjet Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Një çështje tjetër e rëndësishme për të cilën është diskutuar në këtë mbledhje është dhe eksportimi i burimeve të kategorisë së I, që ndodhen në Shqipëri. Në total janë katër burime radioaktive të kësaj kategorie. Në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtimit, udhëzuesit të tij, dokumentit Nr.1319/3, datë 25.03.2013, “ Mbi politikat për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve” miratuar nga KMR-ja, si dhe urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë Nr.435 datë 14.10.2015, për miratimin e dokumentit “ Mbi hapat strategjikë për menaxhimin e mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”, duhet t’i jepet prioritet zvogëlimit të mbetjeve radioaktive në vend dhe KMR-ja duhet të mbështesë fuqishëm politikën që importuesit të sigurojnë kthimin e tyre tek prodhuesi, ose në një depo për trajtimin e tyre jashtë vendit tonë. Personat fizikë ose juridikë të licencuar, të cilët prodhojnë mbetje radioaktive, janë përgjegjës kryesorë për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive dhe duhet të adaptojnë masa për të zvogëluar prodhimin e tyre në vend, duke siguruar në këtë mënyrë një mbrojtje të publikut, brezave të ardhshëm, si dhe duke mbrojtur ambientin.

Urgjent është eksportimi jashtë territorit të Shqipërisë i burimeve radioaktive Co-60, përkatësisht burimi radioaktiv Co-60 që është kondicionuar dhe është në ruajtje të përkohshme në depon e mbetjeve në IFBZ-së, si dhe Co-60 që gjendet në QSUT, i cili në kushtet aktuale është i papërdorshëm për terapinë e pacientëve në qendrën e radioterapisë.

Për burimin e parë që është i kondicionuar në IFBZ dhe që ka qenë në përdorim nga QSUT-ja, nuk ekziston asnjë kontratë apo marrëveshje për kthimin e tij mbrapsht tek prodhuesi. Për këtë arsye është lënë në ruajtje të përkohëshme në depon e mbetjeve pranë IFBZ-së. Ndërsa për burimin e dytë ekziston një kontratë me kompaninë kanadeze për kthimin e tij mbrapsht në fund të jetës.

Kryetari i KMR-së udhëzoi që institucionet përgjegjëse të mbledhin informacionin e duhur, të bëjnë një preventiv paraprak në lidhje me kostot për transportin e tyre, mbi bazën e të cilit do

të alokohet një shumë e caktuar në buxhetin e QSUT-së nga fondi i emergjencave, në mënyrë që të bëhet mbulimi i këtyre shpenzimeve.

Mbledhja e datës 24 Gusht 2016

Çështjet kryesore të diskutuara si dhe vendime të marra në këtë mbledhje:

Në këtë mbledhje KMR-ja ka **miratuar udhëzuesin** “Për procedurat për lëvizjen fizike të materialeve radioaktive, mallrave dhe reagimit në rast incidenti me burime radioaktive në pikat doganore”, i cili është rishikuar nga ZMR-ja dhe ka marrë në konsideratë elementë shtesë të cilat lidhen me kushtet e reagimit në rast dedektimi të një burimi radioaktiv të jashtëligjshëm në pikat doganore, elementë të cilët mungonin në dokumentin e parë, të miratuar nga KMR-ja me Nr.1526/2, datë 13.04.2012, i cili shfuqizohet me miratimin e udhëzuesit të ri. KMR-ja vendosi botimin e udhëzuesit në fletoren zyrtare, si dhe data e hyrjes në fuqi të tij të jetë 1 tetor 2016.

KMR-ja në këtë mbledhje, pas shqyrtimit të dokumentacionit, ka pajisur me Aktmiratimi 165 Stacione Bazë, të cilat i përkasin kompanive të transmetimit celular “Vodafone Albania”, “Albtelekom”, “Telekom Albania” dhe “Plus Communication”, të cilat ishin në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për Stacionet bazë të cilat nuk plotësonin kriteret për t’u pajisur me aktmiratimi, ZMR-ja ju ka dërguar shkresë kompanive duke sqaruar arsyet e mos pajisjes me aktmiratimi, si dhe plotësimin e kërkesave rregullatore, në përputhje me procedurat në fuqi.

Duke parë ndjeshmërinë që ka publiku ndaj rrezatimeve jojonizuese, KMR-ja ka marrë vendim që të organizohet një emision televiz, pjesë e të cilit të jenë ekspertë të kësaj fushe, përfaqësues të ZMR-së etj, - qëllimi i të cilit të jetë informimi dhe ndërgjegjësimi i opinionit publik ndaj rrezatimeve jojonizuese, që shpesh ndodh të ngatërrohet nga gazetarë të ndryshëm me rrezatimet jonizuese, duke e quajtur “radioaktiv” dhe duke i dhënë publikut informacionin e gabuar. Kryetari i KMR-së, ngarkoi Z.Paci të bashkëpunojë me Z.Thanas Goga, Këshilltar për Mediat në Ministrinë e Shëndetësisë, për realizimin sa më shpejt të këtij emisioni.

KMR-ja mori vendim dhe miratoi në këtë mbledhje licencat për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues si më poshtë:

1. Spitali Kavajë, (Grafi/Skopi, Grafi)
2. Grafi dentare “Anjeza Shabanllari”, Tiranë, (Panoramex dhe grafi dentare)
3. Klinika dentare “Koral”, Tiranë (Grafi dentare për përdorim personal)
4. Klinika radiologjike “Logli”, Gjirokastrë, (CT-Skaner dhe grafi/skopi)
5. Kompania “Nasto Inxhiniering”, Vlorë, (Transport të burimeve të rrezatimit jonizues).
6. Grafi dentare “Balla”, Vorë, (Panoramex dhe grafi dentare)
7. Klinika “Dixhital Kavaja”, Kavajë, (Panoramex)
8. Klinika “Arjon”, Tiranë, (Panorameks)
9. Laboratori “Neo Style”, Tiranë, (Densitometri të kockave dhe analiza in Vitro RIA)
10. Klinika “Aida Dental”, Tiranë, (Panorameks)
11. Klinika dentare “Gazioni”, Kavajë, (Panorameks)
12. Royal Diagnostic Center, Tiranë, (Grafi/Skopi, mamografi, CT-Skaner)
13. Grafi dentare “Toska”, Elbasan, (Panorameks dhe grafi dentare)
14. Spitali Amerikan, Tirana I, Tirana II, Durrës dhe Fier, (Grafi/Skopi, CT-Skaner. Koronarografi, C-Arm, Litotripter, Grafi e lëvizshme, Mamografi si dhe përdorim të lëndëve të hapura radioaktive Mo-99/Tc-99m dhe I-131, të cilat do të përdoren për diagnostikimin dhe terapinë e pacientëve në mjekësinë bërthamore)

15. Spitali European, Tiranë, (Grafi/Skopi, Mamografi, CT-Skaner, Koronarografi)
16. Klinika “Amavita”, Tiranë, (Grafi, Mamografi dhe CT-Skaner)
17. Doctors Hospitals, Tiranë, (Grafi, mamografi, densitometri të kockave)

KMR-ja aprovoi importin e dy burimeve Ir-192, grafi industriale, të cilat do të përdoren nga kompania “Nasto inxhiniering”, për kontrollin e saldimit.

Të gjithë subjektet që aplikojnë për licencë, kanë paraqitur gjatë procesit të aplikimit për licencë, vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, ku tregohet që subjekti nuk ka detyrime tatimore të pashlyera pranë kësaj drejtorie.

Bazuar në vërtetimet e dorëzuara, rezulton se disa nga këto subjekte kanë shlyer detyrimet tatimore, por nuk kanë shlyer sigurimet shoqërore dhe ato shëndetësore; disa rezultojnë të kenë gjoba të ndryshme për të cilat janë në proces ankimimi.

Në rastet kur subjektet janë në proces ankimimi, do të vepohet si në rastin e procedimit të tenderave, ku sipas saj, subjekte të cilat kanë marrëveshje me Drejtorinë Rajonale Tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore, apo kanë në proces ankimimi gjoba të ndryshme, pranohen të marrin pjesë në këtë proces. Nuk marrin pjesë në këtë proces ato subjekte të cilat kanë shlyer sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë pjesë e detyrimeve tatimore.

Në këto kushte KMR-ja mori vendim që këto subjekte të pajisen me licencë për ushtrimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues. Ndërsa subjektet që nuk kanë shlyer sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të mos pajisen me licencë. Këto subjekte janë si më poshtë:

1. Klinika “Eleni Sulaj” me qendër në rrugë “Sulejman Delvina” dhe qendër të dytë në “Rrugë e Kavajës”

Kryetari i KMR-së, urdhëroi që në kuadër të bashkëpunimit me ISHSH-në, të organizohet një takim pas datës 10 shtator 2016, me Z. Eltar Deda, Kryeinspektor i ISHSH-së, ku qëllimi i takimit të jetë diskutimi i problematikës së hasur nga ky inspektorat gjatë inspektimeve të kryera në qendrat me veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, si dhe bashkëpunimi i mëtejshëm për gjetjen e zgjidhjeve dhe mbarëvajtjen e këtij procesi.

KMR-ja miratoi në këtë mbledhje udhëzuesin “Mbi metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative gjatë procesit të inspektimit nga inspektorët e ZMR-së”. Udhëzuesi do të botohet në fletoren zyrtare si dhe data e hyrjes në fuqi të tij të jetë 1 tetor 2016.

KMR-ja në këtë mbledhje është shprehur dakord për zhvillimin e misionit këshillues në Shqipëri, i cili ka si qëllim vlerësimin e statusit aktual të infrastrukturës kombëtare rregullatore për sigurinë nga rrezatimet në përputhje me standardet e ANEA-s. Në fund të misionit do të përgatitet një raport, i cili do të përfshijë konkluzionet, rekomandime për përmirësim si dhe plan veprimi për forcimin e infrastrukturës rregullatore si dhe proceseve rregullatore që lidhen me tre shtyllat bazë: licencimin, inspektimin dhe sanksionet.

KMR-ja mori vendim që misioni të realizohet gjatë vitit 2018, pasi Shqipëria të ketë plotësuar dhe pyetësorin përkatës për këtë mision, si dhe KMR-ja merr përsipër shpenzimet për drekat, kafet gjatë pushimeve, si dhe një darkë mikpritjeje zyrtare, shpenzime, të cilat arrijnë shumën rreth 2000 Euro. Kostot për ekspertët do të mbulohen nga ANEA.

KMR-ja autorizoi Z.Bregu, që shpenzimet lidhur me këtë mision të përfshihen në projekt buxhetin e ISHP-së për vitin 2018.

Anëtarët e KMR-së u bënë me dije se Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka përgatitur raportin kombëtar në lidhje me Konventën mbi Sigurinë Bërthamore. Raporti përfshin kuadrin ligjor në këtë fushë, procesin e licencimit të veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, procesin e inspektimit, sistemin e vlerësimit, implementimi i rregulloreve ekzistuese, statusi i trupës rregullatore në këtë fushë, si dhe plani ose programet në rast emergjence radiologjike. Raporti është dorëzuar brenda afateve në Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike në Vjenë, ka patur dhe pyetje nga ekspertë të këtij institucioni, për të cilat ZMR-ja ka dhënë përgjigjet përkatëse.

Në këtë mbledhje janë diskutuar dhe disa ankesa

- **Kompania “Telekom”, mbi mënyrën e pagesës për Stacionet Bazë.**

- QSUT, mbi argumentimin e fondit për eksportin e dy burimeve radioaktive të Co-60.

- Kompania “TEA” sh.p.k, mbi detyrimet tatimore që ka ky subjekt dhe si rezultat i të cilave i është refuzuar miratimi i licencës nga KMR-ja.

- Ankesa e Znj. Miranda Haxholli, në lidhje me vendosjen e antenave të transmetimit celular mbi tarracën e pallatit ku ajo banon - (Teuta 2, Durrës).

Gjithashtu një vendim i marrë nga KMR-ja në këtë mbledhje ishte që, në kushtet për marrjen e licencës për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, të jetë dhe kontrolli teknik i pajisjeve diagnostikuese të cilat përdoren në mjekësi. Ky vendim bëhet në zbatim të VKM-së Nr.404, datë 18.06.2014, për “Rregullat bazë të instalimeve radiologjike në mjekësi”, e cila ka hyrë në fuqi në janar 2015. Kontrolli teknik i këtyre pajisjeve do të bëhet nga IFBZ-ja, si dhe kompania “Edna Farma”, të cilat kanë kapacitete teknike dhe njerëzore, si dhe janë njohur nga KMR-ja për kryerjen e këtij kontrolli.

Mbledhja e datës 18 Nëntor 2016

Çështjet kryesore të diskutuara si dhe vendime të marra në këtë mbledhje:

Miratim i udhëzuesit mbi mënyrën e llogaritjes së sanksioneve, i cili është ndryshuar duke ju referuar mungesës së elementëve në listat e kontrollit, si dhe mënyrës së miratimit të tyre. Anëtarët e KMR-së vendosën që, listat e kontrollit **janë dokumenta që ndryshojnë në kohë dhe mund të shtohen në numër sipas praktikave të punës në ZMR.**

KMR-ja miratoi Udhëzuesin mbi mënyrën e llogaritjes së sanksioneve, si edhe vendosi që Listat e Kontrollit të miratohen me urdhër nga ana e Kryetarit të ZMR-së.

KMR-ja pasi shqyrtoi aplikimet për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues, pajisi në këtë mbledhje me Aktmiratimi 195 Stacione Bazë, të cilat i përkasin kompanive të transmetimit celular “Vodafone Albania”, “Albtelekom”, “Telekom Albania” dhe “Plus Communication”.

KMR-ja mori vendim dhe miratoi në këtë mbledhje licencat për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues si më poshtë:

1. Subjekti “Gentian Ismailaj”, (Panorameks dhe Grafi dentare)
2. Studio Imazherie “Gega”, (Radiografi, CT-Skaner, Mamografi dhe Panorameks)
3. Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” (Grafi/Skopi, CT-Skaner dhe Angiografi)
4. Pets & Partners, Sh.p.k, (Grafi)
5. “City Dental Clinic”, (2 Grafi Dentare Intraorale dhe Panorameks)
6. Spitali Amerikan III, Sh.a, (2 Grafi, CT-Skaner, 2 Angiografi, C-Arm, Grafi e lëvizshme dhe Mamografi. Si dhe përdorim të lëndëve të hapura radioaktive Mo-

99/Tc-99m dhe Gamma Camera , të cilat do të përdoren për diagnostikimin dhe terapinë e pacientëve në mjekësinë bërthamore në Spitalin Amerikan III)

7. “Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar”, (për përdorim të burimeve të rrezatimit jonizues, transport të burimeve të rrezatimit jonizues, ruajtje të përkohshme të burimeve të rrezatimeve jonizuese, import-eksport të burimeve të rrezatimeve jonizuese dhe trajtim të mbetjeve radioaktive)
8. Klinika “Glob Diagnostic Center”, (Grafik dhe CT-Skaner)
9. Kabinet Stomatologjik ENV, (Panorameks/ Cefalometri dhe Grafik dentare)
10. “Dodbiba DENTAL” , (Panorameks/ Cefalometri dhe Grafik dentare)

Gjithashtu, në mbledhje u diskutua dhe u mor vendimi që subjektet do të pajisen fizikisht me licencën e tyre vetëm pasi të jenë pajisur me dokumentin për kontrollin teknik të pajisjeve diagnostikuese, të cilat përdoren në mjekësi nga IFBZ-ja ose kompania Edna Farma (të njohura nga KMR-ja për kryerjen e këtij kontrolli).

KMR-ja mori vendim dhe ka miratuar në këtë mbledhje, si Ekspert të kualifikuar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese, si më poshtë:

1. Z. Fatos YLLI
2. Z. Gerti XHIXHA

Në lidhje me aplikimin e Z. Partizan MALKAJ , KMR-ja vendosi të rishikohet dhe verifikohet edhe një herë dosja në lidhje me pajisjet dhe regjistrimin në QKB, dhe të diskutohet në mbledhjen e ardhshme të KMR-së.

Anëtarët e komisionit u njohën me raportin e auditit të kryer nga grupi i punës së IQ-së, rekomandimet e bëra nga IQ në lidhje me gjetjet gjatë auditit, si edhe me komentet kontestuese të bëra nga ana e ZMR-së. U diskutua rekomandimi Nr.5, ku thuhet se: “ZMR-ja duhet të fillojë inspektimin e zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jojonizues, për aq sa është e mundur”. Kryetari i KMR-së propozoi marrjen me qira të pajisjeve për matjen e rrezatimeve jojonizuese. Ky propozim u diskutua por nuk gjeti mbështetje, pasi këto pajisje mund të duhen të përdoren në periudha kohore të ndryshme dhe kjo periudhë kohore nuk mund të përcaktohet paraprakisht. Propozimi i dytë ishte që kryerja e këtyre matjeve të bëhet nga kompani, të cilat plotësojnë kriteret për këtë proces. Ky propozim ishte më i pranueshëm për anëtarët e KMR-së dhe do të diskutohet në vazhdim. Për këtë duhen përcaktuar kriteret për njohje nga ana e kompanive dhe më tej, të përgatitet raporti i matjeve në terren dhe të vlerësohet nga ana e ZMR-së dhe KMR-së. Në rastin e interesit publik subjektet paguajnë shpenzimet dhe në rastin e interesit privat paguajnë vetë personat e interesuar.

Anëtarët e KMR-së ranë dakord dhe morën vendim për trajnimin dhe testimin e punonjësve të ZMR-së në një kohë të përshtatshme.

Kryetari i KMR-së ka lënë si detyrë në këtë mbledhje që, ZMR-ja të informojë komisionin në momentin e dorëzimit të raportit përfundimtar të misionit IPPAS të zhvilluar në Shqipëri, raport i cili nuk ka ardhur ende.

Një pikë tjetër e diskutimit në këtë mbledhje ishte për burimet radioaktive që ka QSHNG-ja, subjekt i cili ushtron veprimtarinë e tij pa licencë, ndërkohë që dhe burimet radioaktive nuk përdoren prej një kohe shumë të gjatë. Anëtarët e KMR-së pasi diskutuan sesi duhet të veprohet me këto burime, caktuan Znj. Antoneta NJEHRRENA, juriste e KMR-së që t'i shkruajë Z. Koli BELE (Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë), lidhur me këtë çështje dhe të informohet KMR-ja në mbledhjen e ardhshme.

DOKUMENTA LIGJORË TË MIRATUARA GJATË 2016

1. Rregullore Nr.638 datë 7.9.2016, “Për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”
2. Rregullore Nr.815 datë 16.11.2016, “Për transportin e sigurtë të materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”
3. Udhëzues për procedurat për lëvizjen fizike të materialeve radioaktive, mallrave dhe reagimit në rast incidenti me burime radioaktive në pikat doganore Nr.1885/6, datë 19.09.2016.
4. Udhëzim për metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit nga inspektorët e ZMR-së Nr.1885/7, datë 19.09.2016.
5. Listat e kontrollit si më poshtë:
 - a. Për burime të hapura
 - b. Për burime të mbyllura
 - c. Për gjeneratorë me rreze X
 - d. Për transportin e materialeve radioaktive

REALIZIMI I MISIONIT IPPAS NË SHQIPËRI

Në kuadër të bashkëpunimit me ANEA-n dhe me kërkesë të shtetit Shqiptar, në datat 16-26 maj 2016, në Shqipëri u zhvillua misioni IPPAS, i cili kishte si qëllim vlerësimin në lidhje me sigurimin fizik të burimeve radioaktive, duke e krahasuar atë me praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe do të bëjnë rekomandimet e tyre për përmirësime.

Pjesë e këtij misioni ishin institucione të cilat përfshihen në këtë proces si, KMR-ja, IFBZ-ja, AKOB-i, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Policia Kufitare dhe QSHNG-ja.

Pas disa takimeve parapërgatitore në lidhje me këtë mision u përgatit nga ana e ZMR-së një plan masash për realizimin me sukses të tij, si dhe janë organizuar takime me përfaqësues të institucioneve, ku janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e çdo institucioni të përfshirë në procesin e sigurimit të burimeve radioaktive. Pas përfundimit të misionit u përgatit nga grupi i ekspertëve, drafti i parë i raportit në lidhje me situatën e gjetur në Shqipëri, për të cilin çdo institucion bëri komentet përkatëse dhe tashmë jemi në pritje të dërgimit të raportit përfundimtar nga ana e këtij misioni.

PLANI KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT (PKMZSA)

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet edhe gjatë këtij viti ka punuar për përshtatjen e legjislacionit shqiptar, që përfshin mbrojtjen nga rrezatimi me legjislacionin europian në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Europë. Detyrimet që duhet të përmbushë Shqipëria reflektohen në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKMZSA), që është instrumenti bazë i procesit të Integritetit Europian. Raportimet për progresin e arritur për PKMZSA-në, të dërguara pranë MSH-së dhe MIE-së në shqip dhe anglisht për kapitullin 15, Energy (Nuclear Safety and Radiation Protection), si dhe kapitullin 28, Consumer and Health Protection.

BAZA E TË DHËNAVE MBI TRAFIKUN ILEGAL

Shqipëria është përfshirë në sistemin e Bankës së të Dhënave për Trafikun Ilegal (BDTI) të lëndëve radioaktive pranë Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA). ZMR-ja ka vazhduar punën për mbledhjen e të dhënave dhe sistemimin e këtij lloji informacioni.

SEMINARE, TAKIME DHE TRAJNIME

Në kuadër të bashkëpunimit me ANEA-n dhe projekteve rajonale është siguruar pjesëmarrja në seminare, si dhe takime të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar. Shqipëria gjatë 2016 i ka dhënë asistencë trupës rregullatore në Zambia duke trajnuar për dy muaj një inspektore në lidhje me aspektet rregullatore.

ADMINISTRIMI

Në librin e protokollit për vitin 2016 janë regjistruar 122 shkresa të ardhura në ZMR dhe 203 shkresa të dërguara nga ZMR-ja.

Shkresat e ardhura në ZMR gjatë vitit 2016

Në ZMR kanë ardhur 122 shkresa zyrtare ku tematika kryesore ka qenë :

1. Korrespondenca me kompanitë e transmetimit celular, Vodafone Albania sh.a, Telekom Albania, Plus Communication dhe Albtelekom në lidhje me vlerësimin e stacioneve të përbashkëta.
2. Shkresa të ardhura nga Inspektorati Qendror për miratimin e draftregulloreve që lidhen me procesin e inspektimit në RSH, si dhe raportet e mbikqyrjes mbi zbatimin e rekomandimeve të ushtuar pranë ZMR-së .
3. Kërkesa të ndryshme për t'u pajisur me licencë, amendim licence, informacion në zbatim të ligjeve "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese" dhe "Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese".
4. Informacion në lidhje me tarifat për pajisjen me aktmiratimi të stacioneve bazë.
5. Kërkesa për import dhe eksport të burimeve të rrezatimit jonizues.
6. Shkresa nga Avokati i Popullit, ku problematika kryesore ka qenë shqetësimet e ngritura nga banorë të ndryshëm në lidhje me rrezatimet jojonizuese.
7. Shkresa nga Prokuroria e Rrethit Tiranë në lidhje me veprimtaritë me burime të rrezatimit jojonizues
8. Pjesë e letrave të ardhura në ZMR kanë qenë dhe ankesat nga banorët në lidhje me vendosjen e antenave të kompanive celulare.

Shkresat e dërguara nga ZMR-ja gjatë vitit 2016

ZMR-ja ka dërguar 203 shkresa zyrtare ku tematika kryesore ka qenë:

1. Shkresa kompanive të transmetimit celular në lidhje me vlerësimin e shpërndarjes së rrezatimit jojonizues për SB të përbashkëta.
2. Shkresa dërguar Inspektoratit Qendror në lidhje me programin mujor të inspektimeve si dhe raportimet për inspektimet e kryera të çdo muaji.
3. Përgjigje ankesave të qytetarve në lidhje me problematiken e antenave të kompanive celulare.

4. Përgjigje zyrtare kompanive celulare në lidhje me vendimet e marra nga KMR-ja, si dhe subjekteve për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues
5. Shkresa zyrtare me Prokurorinë e Shkallës së Parë në lidhje me problematikën e ankesave të banorëve për antenat celulare.
6. Shkresa zyrtare Ministrive dhe institucioneve të ndryshme për bashkëpunim.
7. Njoftim i subjekteve shtetërore dhe private në lidhje me inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues

Lidhur me çështjet e mbrojtjes nga rrezatimi do të gjeni informacion më të hollësishëm në faqet zyrtare të internetit <http://www.shendetesia.gov.al/al/lidhje/komisioni-i-mbrojtjes-nga-rrezatimi> ose www.ishp.gov.al/cat/rpo



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK